



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER REDI B. SINA
ADRESA FARKE, KOPSHTI
BOTANIK, PALL "SYRI I LIQENIT"
TEL: 697941342

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHEME (AKSIONE)

Nr. repertori: 1306

Nr. koleksioni: 424

Tirane më 05/10/2021

Ligjet referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqiperisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarët"

*Akti notarial përbëhet nga 6 fletë



A2021051410046317116



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Sot, më datë 05. 10. 2021 (dymije e njezete e nje), perpara meje Noter REDI B. SINA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, ne ambjentet e Kryegjyshates Boterore Bektashiane, me adresë ne Rruga "Dhimiter Kamarda" Tirane, u paraqiten personalisht:

SHITES:

Fondacioni "Firdeus", e regjistruar si person juridik me Vendim Gjykate Nr. 576 datë 15.12.2016, dhe e regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L71627453O, me adresë ne Tirane, e përsaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z.Illr Naçi, atësia Muharrem, amësia Dylbere, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Ali Demi; Nd. 5; H. 2; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 1; Njesia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 03/11/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036672028 dhe nr. personal H11103031L.

BLERES:

KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE, e regjistruar sipas të drejtës shqiptare me vendim gjykate nr 4760/1 datë 04.10.2005, dhe e regjistruar në organet tatinore me NIPT J 81606002Q, e përsaqësuar nga Haxhi Baba Edmond Brahimaj (BABA MONDI), atësia Hysen, amësia Merushe, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë S. Delvina; Nd. 008; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 19/05/1959, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035352885 dhe nr. personal F90519026C.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit sipas kushteve dhë përektimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Të dhënët paraprake

1. Pala shitëse në bazë të Ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, datë 04.10.2021, zoteron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "SPITALI CONTINENTAL" sh.p.k, NUIS L51308022F, me vlerë totale prej ALL 100.000.000 (njëqind milionë Lekë) të cilat korespondojnë me 1 (një) kuotë në shoqërinë "Spitali Continental" sh.p.k.
2. Pala shitëse në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë "SPITALI CONTINENTAL" sh.p.k, ka shprehur vullnetin e saj me vendimin e datës 04.10.2021 që ti transferojë nëpërmjet



A2021051410046317116

shitblerjes Palës Blerëse 100% të kuotave të kapitalit të cilat zoteron në shoqërinë "SPITALI Continental" sh.p.k., duke përcaktuar çmimin e blerjes dhe ka autorizuar Drejtorin Ekzekutiv të saj z.Ilir Naçi, të lidhë në emër dhe për llogari të Palës Shitëse kontratën për shitblerjen e kuotës.

3. Shitësi deklaron në këtë kontratë se Spitali Continental është regjistruar në regjistrin tregtar dhe i identifikuar me Nipt L51308022F, ka marrë licencën përkatëse për të ofruar shërbime spitalore dhe ushtron aktivitetin përkatës në përputhje të plotë me legjislacionin e zbatueshëm shqiptar.
4. Shitësi deklaron në këtë kontratë së kuotat e Spitalit Continental objekt veprimi i këtij akti juridik nuk janë përdorur si mjet për sigurimin e ekzekutimit të ndonjë detyrimi pra nuk janë objekti i ndonjë barre të çfarëdo lloj natyre dhe janë të lira për kalimin e pronësisë me çfarëdo lloj veprimi Juridik të lejueshëm nga legjislacioni Shqiptar.
5. Shitësi dhe blerësi kanë personalitet juridik, ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin dhe nuk kanë ndonjë pengesë korporative apo të çdo forme për të hyrë në këtë veprim juridik.
6. Do të konsiderohen si pjesë të pandashme të kësaj kontratë, dhe janë dorëzuar pranë noterit në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, *Vendimi i Bordit të Fondacionit "FIRDEUS"* për miratimin dhe autorizimin e transaksioneve të parashikuara në këtë kontratë për llogari të Shitësit dhe dokumentacioni ligjor i *Kryegjyshatës Botërore Bektashiane*.
7. Pala shitëse deklaron se aksionet ose kuotat që zoteron te Spitali Continental janë të lira dhe nuk ka asnjë dijeni në asnjë formë që mund të jenë të blokuara me vendim gjykate të formës se prerë, dhe garanton blerësin se nuk ka asnjë detyrim në marrëdhënie me të tretë që mund të bëhen shkak për blokimin e aktivitetit.

Palët në cilësinë që ju njeh ligji në Republikën e Shqipërisë dhe me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord të hartojnë, të nënshkruajnë dhe respektojnë këtë marrëveshje si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekt i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është transferimi me kundërshpërbllim, me anë të kontratës së shit-blerjes i kuotave së shoqërisë "Spitali Continental" me nipt L51308022F me vlerë ALL 100.000.000 (njëqind milion) Lekë të kapitalit, zotruar 100% nga Fondacioni "Firdeus", nga shitësi te blerësi.

Neni 2

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

2.1 Palët bien dakord se shuma e çmimit të blerjes do të jetë përfundimtare dhe çmimi që blerësi do të paguajë për shitblerjen do të jetë çmimi maksimal dhe Shitësi garanton Blerësin se ky i fundit nuk do të paguajë ndonjë çmim tjeter përvèç çmimit të blerjes të pasqyruar në këtë kontratë.

2.2 Shitësi pranon se është përgjegjës për të paguar detyrimet tatimore (të tillë si tatimi mbi kapitalin, tatimi mbi fitimin, tatimi mbi të ardhurat dhe çdo detyrim tjeter) sipas legjislacionit në fuqi, vetëm për periudhën përpëra kalimit të titullit të pronësisë në përputhje me nenin 4 të kësaj kontrate.

2.3 Shitësi pranon se është përgjegjës për të paguar drejtpërsëdrejti në organet tatimore ose për të kompensuar Blerësin, taksa apo detyrime të çfarëdolloj forme apo natyre, që mund t'i ngarkohen shoqërisë "Spitali Continental" në të ardhmen nga organet tatimore apo organe të tjera shtëterore, si



A2021051410046517116

rezultat i çfarëdolloj kontrolli të shoqërisë "Spitali Continental" për periudhën që "Spitali Continental" ka qenë i administruar dhc në pronësi të palës shitëse deri në momentin e kalimit të pronësisë palës blerëse.

Për efekt të llogaritjes së datës së transferimit të kuotës, palët kanë rënë dakord se data të cilës do ti referohen do të jetë data në të cilën kuota do të nënshkruhet kontrata e shitblerjes së kuotave në favor të palës blerëse referuar nenit 4 më poshtë.

2.4 Shitësi ka detyrimin dhe merr përsipër të mbajë një aktivitet normal tregtar dhe kontabël në intervalin kohor që pason datën e Bilancit deri në ditën e transferimit të pronësisë mbi kuotën palës blerëse, duke shmangur veprimet që sjellin ndryshime/devijime madhore të llogarive kontabël.

Shitësi nga momenti i lidhjes së kësaj kontrate dhe deri në transferimin e kuotës, nuk do të krijoj asnjë marrëdhënie të re me palët e treta apo të përsëriti marrëdhëniet që ka krijuar me palë e treta ekzistuese.

2.5 Shitësi deklaron se i ka dhënë Blerësit informacion të saktë dhe të vërtetë mbi statusin ligjor, gjendjen dhe përformancën financiare dhe ekonomike të Spitalit Continental dhe se asnjë organ shteteror, institucion apo palë e tretë nuk ka asnjë pretendim ndaj Spitalit Continental duke konsideruar faktin se Spitali Continental ka ushtruar aktivitetin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ka respektuar dhe shlyer çdo marrëveshje apo kontratë ndaj palëve të treta qofshin këto private apo publike, të çfarëdolloj forme apo natyre, të maturuar apo të pagueshëm deri në datën e nënshkrimit të kontratës dhe depozitimini e saj në QKB për ndryshimet përkatëse.

2.6 Shitësi merr përsipër se çdo pretendim i ndonjë organi/institucioni shtetëror apo i ndonjë pale të tretë që mund të ngrihet në të ardhmen në lidhje me veprimtarinë e Spitalit Continental apo të Shitësit deri në datën e transferimit të kuotës do të jetë detyrim dhe përgjegjësi e tij dhe nuk do të ketë asnjë efekt apo detyrim mbi Blerësin.

2.7 Spitali Continental ka titull të mirë dhe të tregtueshëm të aseteve pronë e saj, të cilat janë të fituara ligjërisht dhe janë të lira nga çdo barrë e çfarëdo lloj forme apo natyre.

2.8 Shitësi në këtë kontratë heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo kufizim në transferim (duke përfshirë të drejtat e parablerjes, etj.) që mund të ekzistonjë në lidhje me kuotat, qoftë sipas neneve të Statutit të Spitalit Continental, ndonjë kontrate apo ligjeve përkatëse.

2.9 Pa rënë në kundërshtim me sa më sipër, Shitësi është përgjegjës dhe merr përsipër çdo detyrim të sotëm apo të ardhshëm që lidhet me aktivitetin e Spitalit Continental dhe aseteve të tij, përpëra çdo gjykate a arbitrazhi osc trupi/organi qeveritar, agjenti apo zyrtari që lidhet me objektin e aktivitetit të veprimtarisë apo veprimtarine e Spitalit Continental apo asetet e saj deri në çastin/datën e kalimit të pronësisë mbi kuotën e Spitalit Continental. Çdo pretendim i ardhshëm i ndonjë organi, institucioni shtetëror apo pale të trete që lidhet me aktivitetin e Spitalit Continental për periudhën deri në datën e kalimit të kuotave, do të jetë përgjegjësi dhe në ngarkim të shitësit.

2.10 Shitësi ka të drejtë të kërkojë përbushjen me korrektësi, dhe në afatet e përcaktuara në këtë kontratë, të kushteve dhe detyrimeve të marra përsipër nga Blerësi.

2.11 Blerësi jashtë vlerës që do të paguajë për blerjen e kuotës ka detyrimin të paguajë tarifat për regjistrimin ose transferimin e pronësisë mbi kuotën, nëse është e aplikueshme.

2.12 Blerësi ka detyrimin të mbulojë, jashtë kostove të blerjes së kuotës, kostot e transaksionit si kostot notariale dhe kosto të ngjashme.



A2021051410046317116

2.13 Blerësi ka detyrimin të paguajë në kohë të gjitha detyrimet monetare sipas përcaktimeve të kasaj kontrate.

2.14 Blerësi deklaron se është në dijeni të plotë (për aq sa i është vënë në dispozicion nga Shitësi) të statusit ligjor, ekonomik dhe financiar të Spitalit Continental, si dhe inventarit të pajisjeve e makinerive, status që provohet me kontabilitetin e brendshëm të Spitalit Continental të datës 01.10.2021 i vënë në dispozicion të blerësit, dhe është dakort me blerjen e tij.

Neni 3

Cmimi i shitjes dhe mënyra e likujdimit

3.1 Çmimi i shitjes së 100% i aksioneve ose kuotave të Spitalit Continental është shuma prej 85.000.000 (tetëdhjetë e pesë milion) lekë të reja.

3.2 Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, blerësi do të paguajë me anë të transfertës bankare në llogarinë e përcaktuar nga Shitësi (pranë CREDINS Bank), shumën prej 50.000.000 Leke (pesëdhjetë milion lekë). Pavarësisht kësaj, pala shitëse do t'i kalojë të gjitha të drejtat palës blerëse dhe nuk do të këtë asnjë pretendim mbi të drejtat e kuotës së zotëruar prej saj. Të gjitha veprimet për kryerjen e transferimit të kuotës do të kryhen sikur të ishte kaluar e gjithë shuma e dakordësuar.

3.3 Palët bien dakord se diferenca prej 35.000.000 lekë të reja (tridhjetë e pesë milion) nga çmimi total i shitjes prej 85 milion lekë, do të paguhet nga blerësi në nr. e llogarisë pranë bankës që do t'i vihet në dispozicion nga Shitësi, brenda 3 muajve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, por jo më vonë se data 10 Janar 2022. Për detyrimin prej 35.000.000 lekë të reja (tridhjetë e pesë milion) të pasqyruar në pikën 3.3 në këtë kontratë, do të nënshkruhet nga palët dhe një deklaratë noterjale bashkëlidhur kësaj komnrate. Me shlyerjen e vlerës totale sipas kësaj kontrate, pala shitëse deklaron se nuk ka asnjë pretendim kundrejt blerësit Kryeqytshates Boterore Bektashaine.

Neni 4

Kalimi i titullit të pronësisë së Kuotës

4.1 Çasti i kalimit të pronësisë së aksioneve ose kuotave të Spitalit Continental nga shitësi të blerësi është data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

4.2 Regjistrimin e këtij akti juridik (kontrata e shit-blerjes së aksioneve ose kuotave) do ta kryejë blerësi brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 5

Taksat dhe tatimet

Cdo taksë ose tatim i zbatueshëm mbi këtë veprim juridik, të tilla si tatim mbi fitimin kapitalit apo taksa mbi kalimin e aksioneve ose kuotave, etj, nëse janë të zbatueshme do të janë përgjegjësi e Shitësit.

Neni 6

Ligji i zbatueshëm dhc zgjidhja e mosmarrëveshjeve



A2021051410046317116

6.1 Kjo kontatë është e hartuar në përputhje më Legjislacionin Shqiptar. Për çeshtje të paparashikuara në këtë kontratë do të zatohen dispozitat përkatëse ligjore.

6.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me këtë kontratë do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve dhe në zbatim të praktikave më të mira, në të kundërt palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për mosmarrëveshjet midis tyre.

Neni 7
Të ndryshme

7.1 Nëse nëse ndonjë pjesë e kësaj kontrate do të konsiderohet si e pavlefshme ose pa fuqi ligjore për çdo lloj arsyje nga ndonjë gjykatë apo autoritet shtetëror me juridikSION kompetent, atëherë kjo pjesë do të çmohet si e pavlefshme dhe pjesa tjeter e kësaj kontrate do të vazhdojë të mbetet në fuqi dhe efekt juridik të plotë.

7.2 Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve dhe zëvendëson çdo komunikim tjeter me shkrim lidhur me të përpara nënshkrimit të saj. Kjo kontratë nuk mund të ndryshohet apo shtohet përvçese me shkrim dhe e nënshkruar nga përfaqësuesit e të dyja palëve.

Neni 8
Forca madhore

8.1 Asnjëra nga palët nuk do të mbajë përgjegjësi kundrejt palës tjeter për mospërmbushjen e detyrimeve të marra përsipër në këtë kontratë kur realizimi i këtyre detyrimeve është bërë i pamundur apo vonuar për shkak të forcës madhore.

8.2 Për qëllim të kësaj kontratë Forcë Madhore do të konsiderohet një ngjarje apo ndodhi që është përtej kontrollit të arsyeshëm të palëve, e paparashikueshme, e pashmangshme, dhe që e bën të pamundur realizimin e detyrimeve të kësaj kontrate të tillë si lufta, kryengritja, trazira civile, termetë, pandemi, zjarre etj.

Neni 9
Emërimi i përfaqësuesve

9.1 Palët do të emërojnë secili prej tyre një përfaqësues që do të mbajë përgjegjësi për marrëdhënen midis Palëve lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

9.2 Palët do të njoftojnë me shkrim në adresat e tyre përkatëse elektronike për emrin e përfaqësuesit të tyre. Në rast se nga palët do të ndryshohen përfaqësuesit ky njoftim do të bëhet po në adresat e palëve të cilat janë:

Për palën shitëse: Fondacioni Firdeus, Rruga "Ali Demi", nr. 25 Tiranë;

Për palën blerëse: Kryeqytishata Botërore Bektashiane, Rruga "Ali Demi", zyra e protokollit dhe arkivit.



A2021051410046317116

Në cdo rast ndryshimet duhet të kryen brenda afateve të arsyeshme dhe në asnje rast duke cënuar apo penguar ekzekutimin e detyrimeve të marra përsipër nga palët e kësaj kontratë.

NENI 10

ANEKSET E KONTRATËS

10.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës:

- Dokumentacioni ligjor i të dy palëve
- Kopje e kartës së identitetit të përfaqësuesve ligjorë
- Vendimi i bordit të Fondacionit "Firdeus"
- Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë ku do të bëhet pagesa e Fonadacionit Firdeus

NENI 11

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

11.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kupuan përbajtjen e saj dhe meqenësc shprchin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kupuan efektet e saj juridike, e nënshtetet atë rregullisht përpara meje Noterit.

11.2 Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshtemin e tyre.

11.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontratë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUËSE

SHITES

Fondacioni "Firdeus"



NOTER
REDI B. SINA



BLERES

"Kryegjyshata Boterore Bektashiane"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER REDI B. SINA

DATE 05/10/2021
NR REP 1305



V2021051410088843208



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 05.10.2021 (dymije e njezete e nje), perpara meje Noter REDI B. SINA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, FARKE, KOPSHTI BOTANIK, PALL"SYRI I LIQENIT", u paraqiten personalisht:

DEKLARUESIT:

Z.Elvis Naçi, atësia Muhammed, amësia Dylbere, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Ali Demi; Nd. 5; H. 2; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 1; Njesia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 07/04/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037007380 dhe nr. personal H70407042N.

Z.Florian Brinja, atësia Hilmi, amësia Ermira, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Vllazen Huta; Nd. ; Njësia Administrative Nr. 2; Tiranë 2; 0000; Tiranë, lindur më 10/09/1981, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032980699 dhe nr. personal I10910063O.

Z.Marvin Naçi, atësia Ilir, amësia Edlira, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Ali Demi; Nd. 5; H. 2; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 1; Njesia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 03/03/1996, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032480571 dhe nr. personal J60303039R, dhe

Z.Andi Qinami, atësia Gani, amësia Fatmire, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Shyqyri Ishmi P43 Sh2 Ap 29; Nd. ; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 07/05/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036025665 dhe nr. personal I00507068D.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhc kerkuan prçj meje noterit vertetimin e nenshkrimit te tyre ne Vendimin e dates 04.10.2021 te Mbledhjes se Bordit Drejtues te Fondacionit "Firdeus" bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërrma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
REDI B. SINA





Mbledhje e Bordit Drejtues të Fondacionit Firdeus

Datë 4 Totor 2021

Address:

Bruga Ali Demi Nr.25
Tirane, Albania

• www.firdeus.al
✉ info@firdeus.al
📞 +35567 400 6161

Të pranishëm:

Anëtarë Bordi:

Elvis Naci Kryetar (nr. Personal H70407042N)

Florian Brinja Anëtar (nr. Personal I10910063O)

Marvin Naci Anëtar (nr. Personal J60303039R)

Andi Qinami Anëtar (nr. Personal I00507068D)

Të ftuar:

Drejtori Ekzekutiv i Ilir Naçi (nr. Personal H11103031L)

Fondacioni FIRDEUS është zotëruar në masën 100% i kuotave të kapitalit të Spitalit Continental. Pranë Fondacionit FIRDEUS është paraqitur një kërkesë nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane me anën e së cilës është shprehur interesi për të blerë në masën 100% kuotat e kapitalit të Spitalit Continental. Pas bisedimeve të zhvilluara, si dhe në përputhje me statutin e fondacionit, Bordi Drejtues i Fondacionit FIRDEUS i njoftuar dhe mbledhur rregullisht, pasi shqyrtoi kërkesën e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane,

VENDOSI:

- a) Të miratojë shitjen e 100% të kuotave të shoqërisë "SPITALI CONTINENTAL" Sh.P.K., me vlerën totale 85.000.000 lekë të reja (tetëdhjetë e pesë milion), të cilat do të paguhën në 2 periudha nga blerësi Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe përkatësisht: Shuma prej 50.000.000 lekë të reja (pesëdhjetë milion) do të paguhet nga blerësi për llogari të shitësit në datën e nënshkrimit të kontratës dhe diferenca prej 35.000.000 lekë të reja (tridhjetë e pesë milion) do të paguhet nga blerësi për llogari të shitësit brenda datës 10 Janar 2022.
1. Të autorizojë Drejtorin Ekzekutiv të Fondacionit ILIR NAÇI me nr. Personal H11103031L, lindur më 03.11.1971 në Tiranë dhe banues në Tiranë, për kryerjen dhe nënshkrimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për kontratën e shitjes së kuotave të kapitalit të shoqërisë "SPITALI CONTINENTAL" Sh.P.K.

Vendimi u miratua nga Kryetari dhe 3 anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Elvis Naci (Kryetar)

Elvis Naci

Marvin Naci (Anëtar)

Marvin Naci

Andi Qinami (Anëtar)

Andi Qinami

Florian Brinja (Anëtar)

Florian Brinja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. Akti _____

Nr. Vendimi 576



PËR REGJISTRIMIN E PËRSHËNTEJ JURIDIK

Sot, më date 15.12.2016, unë gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kujtim Vranici, mora në shqyrtim kërkesën e Z. Elvis Naçi, i cili kërkon të regjistrohet si person juridik Fondacioni "FIRDEUS" dhe,

KONSTATOVA:

Se kërkuesi Z. Elvis Naçi, me cilësinë e Themeluesit të Fondacionit "FIRDEUS", kërkon të regjistrohet si person juridik Fondacioni "FIRDEUS", me themelues atë vetë.

Fondacioni nuk është një organizatë politike fitimprurëse.

Qëllimi i Fondacionit "FIRDEUS" është:

1. Të kryejë veprimtaritë ndryshme, të krijojë, aplikojë dhe të përkrahë programë me karakter humanitar.
2. Të kryejë veprime të cilat konsistonë në ofrimin e shërbimeve falas, kujdes për të gjitha moshat dhe gjinitë e njerëzve, me qëllim mirëqenie, ruajtje e mbrojje dinjiteti dhe sigurimin e përmirësimin e cilësisë së jetës.
3. Të ndihmojë familjet në nevojë.
4. Të nxisë dhe të krijojë mundësi për punësimin e të rinjve.
5. Të promovojë solidaritetin mes njerëzve dhe krijuimin e mundësive të arsimimit.
6. Të hapë kurse të ndryshme profesionale (trobajepësi, kurse në gjuhë të huaja, etj).
7. Të mbështesë dhe marrë masa për ngritjen e një sistemi efikas të ndihmës psikologjike të njerëzve të traumatizuar dhe të ndihmës emergjente në raste të fatkeqësive natyrore.
8. Të krijojë mundësitë e hapjes së ambienteve të veçanta, ku do të bëhet e mundur ofrimi i shërbimeve të ndryshme për njerëz në nevojë.
9. Të kryejë veprimtaritë për ngritjen dhe sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e programeve dhe aktiviteteve të ndryshme shoqërore, edhe aktivitetet fetare.
10. Krijimin e kushteve barinrëse me qëllim arsimimi e edukimi, sigurimin e mbështetjes të teknologjisë së lartë për të përmirësuar kujdesin shëndetësor, nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore nëpërmjet iniciimit, administrimit,

- zbatimit të projekteve konkrete, të koncepteve dhe praktikave në fushat përkatëse në përputhje me vlerat e organizatës.
11. Krijimin dhe administrimin e projekteve apo organizmave të tjera si persona juridikë ose jo, për realizimin e programave të ndryshme të zhvillimit në fushën mjekësore, të përkujdesjes shëndetësore, të edukimit të të gjitha niveleve, në përmbrushje të qëllimit të Fondacionit.
 12. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e aktivitetave dhe veprimtarive të ndryshme sipas qëllimit të fondacionit në fushën shëndetësore, sociale, shpirtërore, kulturore, atë ekonomike, dhe të fushave të tjera shoqërore.
 13. Sigurimin e mbështetjes së nevojshme për aktivitetet dhe programet e Fondacionit, nëpërmjet ndihmës apo kontributit të personave fizikë apo juridikë, vendas ose të huaj.
 14. Promovimin e qëllimit dhe aktivitetit të Fondacionit apo të projekteve të ndryshme, përmes medias televizive, radiofonike, të shtypshkruar, apo internetit, si dhe çdo platforme tjeter të komunikimit masiv.
 15. Administrimin e pasurisë së Fondacionit në përmbrushje të qëllimit të Fondacionit.
 16. Monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe programeve të Fondacionit për realizimin me cilësi të qëllimit të Fondacionit.
 17. Sigurimin dhe zbatimin në praktikë nga vetë Fondacioni apo nëpërmjet projekteve apo programeve të tij, të koncepteve dhe praktikave inovative në fushat e mbuluara nga qëllimi i Fondacionit.
 18. Ofrimin e ndihmës praktike dhe shërbimeve në të gjitha aspektet e nevojshme për projektet, programet apo organizatat e krijuara nga Fondacioni në përmbrushje të qëllimeve të Fondacionit.
 19. Ofrimin dhe krijimin e mundësive apo platformave të ndryshme, si dhe ngritjen e grupeve të këshillimit për zhvillimin e diskutimeve në fushat të cilat përfshihen në qëllimin e Fondacionit.
 20. Çdo lloj aktiviteti tjeter që çmohet i arsyeshëm në të mirë dhe në interes të publikut, i parashikuar ose jo në qëllimin e Fondacionit dhe që nuk është ndaluar shprehimisht me ligj.

Selia e Fondacionit "FIRDEUS" ndodhet në adresën: Rr. "Zonja Çurte", Pallati "Ermir-Star", kat. 1, Tiranë, Shqipëri.

Fondacioni "FIRDEUS" do të zhvillojë aktivitetin për një periudhë kohe të pacaktuar.

Struktura e Organave Drejtuese të Fondacionit përbëhet nga Bordi Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv.

Bordi Drejtues përbëhet nga:

- Elvis Naçi
- Muhamrem Naçi
- Florian Brinja

Drejtor Ekzekutiv, do të jetë Z. Lir Naçi.

Vlera fillestare e pasurisë së Fondacionit "FIRDEUS" është 100.000 (një qind mijë) lekë.

Mjetet financiare të organizatës jofitimprurëse ndër të tjera janë dhe donacionet nga subjektet fizikë apo juridikë privatë vendas ose të huaj.



Për gjithë sa më lart dhe bazuar në dokumentin "PËRPARA", kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të nenit 39, 55 e vijues, të Kredit Civil, si dhe ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" dhe ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar,

VENDOSA:

Pranimin e kërkesës.

Regjistrimin si person juridik të Fondacionit "FIRDEUS", me themelues Elvis Naçi.

Fondacioni nuk është një organizatë politike fitimprurëse.


Qëllimi i Fondacionit "FIRDEUS" është:

1. Të kryejë veprimtari të ndryshme, të krijojë, aplikojë dhe të përkrahë programe me karakter humanitar.
2. Të kryejë veprime të cilat konsistojnë në ofrimin e shërbimeve falas, kujdes për të gjitha moshat dhe gjinitë e njerëzve, me qëllim mirëqenje, ruajtje e mbrojtje dinjiteti dhe sigurimin e përmirësimin e cilësisë së jetës.
3. Të ndihmojë familjet në nevojë.
4. Të nxisë dhe të krijojë mundësi për punësimin e të rinjve.
5. Të promovojë solidaritetin mes njerëzve dhe krijimin e mundësive të arsimimit.
6. Të hapë kurse të ndryshme profesionale (trobajepësi, kurse në gjuhë të huaja, etj).
7. Të mbështesë dhe marrë masa për ngritjen e një sistemi efikas të ndihmës psikologjike të njerëzve të traumatizuar dhe të ndihmës emergjente në raste të fatkeqësive natyrore.
8. Të krijojë mundësitë e hapjes së ambienteve të veçanta, ku do të bëhet e mundur ofrimi i shërbimeve të ndryshme për njerëz në nevojë.
9. Të kryejë veprimtari për ngritjen dhe sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e programeve dhe aktiviteteve të ndryshme shoqërore, edhe aktivitete fetare.
10. Krijimin e kushteve bamirëse me qëllim arsimimi i edukimi, sigurimin e mbështetjes të teknologjisë së lartë për të përmirësuar kujdesin shëndetësor, nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore nëpërmjet iniciimit, administrimit, zbatimit të projekteve konkrete, të koncepteve dhe praktikave në fushat përkatëse në përputhje me vlerat e organizatës.
11. Krijimin dhe administrimin e projekteve apo organizmave të tjera si persona juridikë ose jo, për realizimin e programeve të ndryshme të zhvillimit në fushën mjekësore, të përkujdesjes shëndetësore, të edukimit të të gjitha niveleve, në përimbushje të qëllimit të Fondacionit.
12. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të ndryshme sipas qëllimit të fondacionit në fushën shëndetësore, sociale, shpirterore, kulturore, atë ekonomike, dhe të fushave të tjera shoqërore.
13. Sigurimin e mbështetjes së nevojshme për aktivitetet dhe programet e Fondacionit, nëpërmjet ndihmës apo kontributit të personave fizikë apo juridikë, vendas ose të huaj.

- Logo
14. Promovimin e qëllimit dhe aktivitetit të Fondacionit apo të projekteve të ndryshme, përmes medias televizive, radiofonike, të shtypshkruar, apo internetit, si dhe çdo platforme tjeter të komunikimit masiv.
 15. Administrimin e pasurisë së Fondacionit në përbushje të qëllimit të Fondacionit.
 16. Monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe programeve të Fondacionit për realizimin me cilësi të qëllimit të Fondacionit.
 17. Sigurimin dhe zbatimin në praktikë nga vetë Fondacioni apo nëpërmjet projekteve apo programeve të tij, të koncepteve dhe praktikave inovative në fushat e mbuluara nga qëllimi i Fondacionit.
 18. Ofrimin e ndihmës praktike dhe shërbimeve në të gjitha aspektet e nevojshme për projekte, programet apo organizatat e krijuara nga Fondacioni në përbushje të qëllimeve të Fondacionit.
 19. Ofrimin dhe krijimin e mundësive apo platformave të ndryshme, si dhe ngritjen e grupeve të këshillimit për zhvillimin e diskutimeve në fushat të cilat përfshihen në qëllimin e Fondacionit.
 20. Çdo lloj aktiviteti tjeter që çmohet i ursyeshëm në të mirë dbe në interes të publikut, i parashikuar ose jo në qëllimin e Fondacionit dhe që nuk është ndaluar shprehimisht me ligj.

Kundër vendimit lejohet ankrim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

U shpall në Tiranë, sot më datë 15.12.2016



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

Nr. 673 Regjistri Themeltar
Date 31.08.2018 Regjistrimi

Nr.576/1 Vendimi
Date 03.10.2018 Vendimi

VENDIM

PËR DEPOZITIM NË REGISTRIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Sot, me datë 03.10.2018 unë Julian Haxhiu, Gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën dhe aktet e paraqitura nga Fondacionit "FIRDEUS përfaqësuar nga Ilir Naçi, i cili kërkoi depozitimin e Vendimit Nr.1 datë 26.03.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit Fondacionit "FIRDEUS", Vendimit Nr.2 datë 26.03.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit Fondacionit "FIRDEUS", Vendimit Nr.3 datë 26.03.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit Fondacionit "FIRDEUS", Vendimit Nr.4 datë 26.03.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit Fondacionit "FIRDEUS"

KONSTATOVA

Se Fondacionit "Firdeus" është regjistruar, si organizatë joftimprurëse në formën e Fondacionit si me Vendimin Nr. 576 dt.15.12.2016, me seli në Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje statutin dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Bordi Drejtues i Fondacionit "FIRDEUS me Vendimin Nr.1 datë 03.08.2018
ka vendosur:

- Zëvendësimi i vendit bosh të lënë nga Z. Muhamrem Naçi(i ndjen) me Z. Marvin Naçi.

Bordi Drejtues i Fondacionit "FIRDEUS me Vendimin Nr.2 datë 03.08.2018
ka vendosur:

- Ndryshimin e Nenit 23.1 "Përbërja e Organeve të Para Drejtuese/Anëtarë të Bordit Drejtues" të Statutit duke shtuar dhe dy anëtarë të rinj, konkretisht Zj. Faime Naçi dhe Z. Andi Qinami.

Bordi Drejtues i Fondacionit "FIRDEUS me Vendimin Nr.3 datë 03.08.2018
ka vendosur:

- Ishte: Rr. Zonja Curre", Pallati "Ermir - Star", katë i parë, Tiranë, Shqipëri.
Të bëhet: Rr. "Ali Demi" Nr. 25, katë i parë, Tiranë, Shqipëri.

Bordi Drejtues i Fondacionit "FIRDEUS me Vendimin Nr.4 datë 03.08.2018
ka vendosur:

- Shtimin e Nenit 16 "Administrata" të Statutit me gërmën A, në të cilët të parashikohet koncepti i "Vullnetarit".

Vendimi i mësipërm është marrë në përputhje me statutin e Fondacionit FIRDEUS dhe në përputhje me ligjin Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat joftimprurëse" i ndryshuar.

Për sa më sipër, kërkesa e paraqitur është e mbështetur në aktet e fondacionit dhe në dispozitat ligjore dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat joftimprurëse" i ndryshuar me ligjin nr.9814, datë 04.10.2007 e ligjin nr.92/2013 si dhe në mbështetje të ligjit nr.8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave joftimprurëse".

VENDOSA

Pranimin e kërkesës.

Depozitimin e Vendimit Nr.1 datë 03.08.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit FIRDEUS".


Depozitimin e Vendimit Nr.2 datë 03.08.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit FIRDEUS".

Depozitimin e Vendimit Nr.3 datë 03.08.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit FIRDEUS".

Depozitimin e Vendimit Nr.4 datë 03.08.2018 të Bordit Drejtues të Fondacionit FIRDEUS".

Urdhërohet Zyra e Regjistrimit e Organizatave Jofitimprurëse për pasqyrimip e ndryshimeve në kolonat përkatëse të regjistrat.

Datë 03.10.2018.



PULLE TARIFE





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
ZYRA E REGJISTRIT TE OJF-ve

TIRANË

Tirane me 17.10.2019

VERTETIM

Me vendimin nr. 576, date 15.12.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte regjistruar si person juridik organizata joftimpreurese e emertuar Fondacioni "FIRDEUS"; me seli ne Tirane, Rruga "Zonja Çutre", Pallati "Etmit - Star", kati 1; me kohezgjatje te papercaknuar; me themelues Elvis Naçi; Bordi Drejtues Elvis Naçi, Muhamrem Naçi, Florian Brinja; Drejtor ekzekutiv eshte z. Ilir Naçi; qellimi fondacionit eshte: te kryeje veprimtari te ndryshme, te krijoje, aplikojte dhe te perkrahe programe me karakter humanitar. Te kryeje veprime te cilat konsistojnë ne ofrimin e shebrimeve falaj, kujdes per te gjitha moshat dhe gjinite e njerezve, me qellim mireqenie, ruajtje e mbrojtje dinjiteti dhe sigurimin e perimiresimin e cilesise se jetes. Te ndihmoje familjet ne nevoje. Te nxise dhe te krijoje mundesi per punesimin e te rinjve. Te promovoje solidaritetin mes njerezve dhe krimin e mundesive te arsimimit. Te hape kurse te ndryshme profesionale (trobaqepesi, kurse ne gjuhe te huaja, etj). Te mbeshtes dhe marre masa per ngrijten e nje sistemi efikas te ndihmes psikologjike te njerezve te traumatizuar dhe te ndihmes emergjente ne raste te fatkeqesive natyrore. Te krijoje mundesite e hapjes se ambienteve te vecanta ku do te behet te mundur ofrimi I shembimeve te ndryshme per njerez ne nevoje.


Me vendimin nr. 576/1, date 03.10.2018 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vodosur depozitimi i vendimit nr. 1 date 03.08.2018 te Bordit drejtues ne te cilin eshte vodosur: Zevendesimi i vendit bosh te lene nga z. Muhamrem Naçi (i ndjeri) me z. Marvin Naçi. Me vendimin nr. 2, date 03.08.2018 te brodit drejtues eshte vodosur: Ndryshimin e nenit 23.1 "Perberja e Organeve te Para Drejtuese/ Anetaret te Bordit Drejtues" te Statutit duke shtuar dhe dy anetare te rinj, konkretisht zj. Fatime Naçi dhe z. Andi Qinami. Me vendimin nr. 3, date 03.08.2018 te Bordit

drejtues eshte vodosur. Ndryshimi i selise nga Rr. Zonja Curri, Pallari "Ermir - Star", kati i pare, Tirane, Shqiperi ne Rr. "Ali Demi", nr. 25, kati i pare Tirane, Shqiperi. Me vendimin nr. 4, date 03.08.2018 te Brodit drejtues eshte vodosur Shtimin e nenit 16 "administrate" te statutit me germen A ne te cilet te parashikohet koncepti i "Vullnetarit".

Ndryshime te metejashe nuk ka.

SEKRETARE REGJISTRIT TE OJF-ve

Besa KORBECI



AKTI I THEMELIMIT

I
Fondacionit "FIRDEUS"

Sot më datën 09.11.2016, në Tiranë, Shqipëri, Z. Elvis Naçi shtetas shqiptar, lindur më 07.04.1977, në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. H70407042V; shpreh vullnetin e tij për themelimin e Fondacionit "FIRDEUS" dhe mbështetur në dispozitat e Kodit Civil dhe të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, harton këtë Akt Themelimi, me përbajtje si më poshtë:

Neni 1
Themeluesi

- 1.1 Krijohet Fondacioni "FIRDEUS", në formën e një organizate jofitimprurëse.
- 1.2 Themelues i Fondacionit "FIRDEUS" është Z. Elvis Naçi.

Neni 2
Lloji, Emri dhe Vula

2.1 Fondacioni "FIRDEUS" (referuar më poshtë si Fondacioni) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse, që mbështet dhe zhvillon tek individi dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbvon jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështeteje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut.

2.2. Vula e Fondacionit është në ngjyrën blu, në formë të rrumbullakët dhe do të përbajë emrin 'Fondacioni FIRDEUS' dhe vendin e themelimit të Fondacionit, 'Tiranë, Albania'.

2.3. Emri dhe Vula e Fondacionit duhet të figurojnë në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del nga Fondacioni.

2.4 Në marrdhëni me organizmat e huaja ose në pjesëmarrjet në veprimtari ndërkombëtar, do të nxitet me emërtimin anglisht 'Foundation FIRDEUS'.

Neni 3
Selia

3.1 Selia e Fondacionit "FIRDEUS" ndodhet në adresën: Rr. "Zonja Çurre", Pallati "Ermir-Star", kat. 1, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Vendndodhja e selisë mund të ndryshohet me vendim të Bordit Drejtues.



13. Siguria e Fondacionit, n
14. Vendas ose ndryshim
15. Pronovisim

Neni 4
Shtrirja Territoriale

- 4.1 Fondacioni "FIRDEUS" zhvillon aktivitetin e tij pa kufizim në të gjithë territoria Republikës së Shqipërisë. Fondacioni "FIRDEUS" mund të krijojë degë të tij në zonat tjetër administrativo-territoriale të Shqipërisë.
- 4.2 Fondacioni "FIRDEUS" njëkohësisht mund të çelë degë ose filiale edhe në shiellje të huaja, sipas legjislatinës së vendeve përkatëse.

Neni 5
Qëllimi dhe Objekti

5.1 Fondacioni "FIRDEUS" ka për qëllim dhe si fushë të veprimtarisë së vet:

1. Të kryejë veprimitari të ndryshme, të krijojë, aplikojë dhe të përkrahë programe me karakter humanitar.
2. Të kryerje veprime të cilat konsistonë në ofrimin e shërbimeve falas, kujdes për të gjitha moshat dhe gjinitë e njerëzve, me qëllim mirëqenie, ruajtje e mbrojtje dinjiteti dhe sigurimin e përmirësimin e cilësisë së jetës.
3. Të ndihmojë familjet në nevojë.
4. Të nxise dhe të krijojë mundësi për punësimin e të rinjeve.
5. Të promovojë solidaritetin mes njerëzve dhe krijimin e mundësive të arsimimit.
6. Të hapë kurse të ndryshme profesionale (trobaqepësi, kurse në gjuhë të huaja, etj.).
7. Të mbështesë dhe marrë masa për ngritjen e një sistemi efikas të ndihmës psikologjike të njerëzve të traumatizuar dhe të ndihmës emergjente në raste të fatkeqësive natyrore.
8. Të krijojë mundësitë e hapjes së ambienteve të veçanta, ku do t'w bëhet e mundur ofrimi i shërbimeve të ndryshme për njerëz në nevojë.
9. Të kryejë veprimitari për ngritjen dhe sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e programeve dhe aktivitetave të ndryshme shoqërore, edhe aktivitete fetare.
10. Krijimin e kushteve bamirëse me qëllim arsimimi e edukimi, sigurimin e mbështetjes të teknologjisë së lartë për të përmirësuar kujdesin shëndetësor, nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore nëpërmjet iniciativës, administrativës, zbatimit të projekteve konkrete, të koncepteve dhe praktikave në fushat përkatëse në përputhje me vlerat e organizatës.
11. Krijimin dhe administrimin e projekteve apo organizmave të tjera si persona juridikë ose jo, për realizimin e programeve të ndryshme të zhvillimit në fushën mjekësore, të përkujdesjes shëndetësore, të edukimit të të gjitha niveleve, në përbushje të qëllimit të Fondacionit.
12. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e aktivitetave dhe veprimitave të ndryshme sipas qëllimit të fondacionit në fushën shëndetësore, sociale, shpirtërore, kulturore, atë ekonomike, dhe të fushave të tjera shoqërore.

13. Sigurimin e mbëshetjes së nevojshme për aktivitetet dhe programet e Fondacionit, nëpërmjet ndihmës apo kontributit të personave fizikë apo juridikë vendas ose të huaj.
14. Promovimin e qëllimit dhe aktivitetit të Fondacionit apo të projekteve të ndryshme, përmes medias televizive, radiofonike, të shtypshkruar, apo internet, si dhe çdo platforme tjeter të komunikimit masiv.
15. Administrimin e pasurisë së Fondacionit në përbushje të qëllimit të Fondacionit.
16. Monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe programeve të Fondacionit për realizimin me cilësi të qëllimit të Fondacionit.
17. Sigurimin dhe zbatimin në praktikë nga vetë Fondacioni apo nëpërmjet projekteve apo programeve të tij, të koncepteve dhe praktikave innovative në fushat e mbuluara nga qëllimi i Fondacionit.
18. Ofrimin e ndihmës praktike dhe shërbimeve në të gjitha aspektet e nevojshme për projektet, programet apo organizatat e krijuara nga Fondacioni në përbushje të qëllimeve të Fondacionit.
19. Ofrimin dhe krijimin e mundësive apo platformave të ndryshme, si dhe ngritjen e grupeve të këshillimit për zhvillimin e diskutimeve në fushat të cilat përfshihen në qëllimin e Fondacionit.
20. Çdo lloj aktiviteti tjeter që çmohet i arsyeshëm në të mirë dhe në interes të publikut, i paparashikuar ose jo në qëllimin e Fondacionit dhe që nuk është ndaluar shprehimisht më ligj.

**Neni 6
Kohëzgjatja**

- 6.1 Fondacioni "FIRDEUS" do të zhvillojë aktivitetin për një periudhë kohe të pacakuar.
 6.2 Kohëzgjatja e veprimitarisë së Fondacionit mund të ndryshohet me vendim të Bordit Drejtues.

**Neni 7
Ndalimi i Shpërndarjes së Fitimeve**

Ndalohet çdo formë e shpërndarjes së fitimit ose përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e Fondacionit "FIRDEUS", prej personave që janë subjekt i Statutit, Aktit të Themelimit, rregulloreve dhe çdo akti tjeter të Fondacionit, përveç detyrimeve në formën e pagave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës dhe kontrata të tjera të ngjashme ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi për llogari të organizatës jo fitimprurëse.

**Neni 8
Burimet Financiare**

8.1 Vlera fillestare e pasurisë së Fondacionit "FIRDEUS" është 100.000 (një qind milionë lekë) e kushtuar si kontribut fillestare i themeluesit dhe e derdhur në llogarinë bankare e Fondacionit.

8.2 Bumështetë ardhurave të organizatës joftimprurëse janë të ardhurat nga kufizimi i tij kur ka të tilla, fonde, grante dhe dhurimet/donacionet e ofruara nga subjektet e përfshirë apo juridikë privatë vendas ose të huaj, nga veprimtaria e Fondacionit në përpjekje me qëllimin e objektin e tij bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës joftimprurëse.

Neni 9

Organet Drejtuese të Fondacionit

9.1 Organet Drejtuese të Fondacionit janë:

1. Bordi Drejtues (BD)
2. Drejtori Ekzekutiv (DE)

Neni 10
Përfaqësimi

10.1 Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit është personi që përfaqëson Fondacionin në marrdhëni me personat e tretë fizikë dhe juridikë.

10.2 Deri në smërimin e Drejtorit Ekzekutiv, nga mbledhja e parë e Bordit Drejtues, funksionet e përfaqësimit i kryen Z. Elvis Naçi, si themelues i Fondacionit.

Neni 11
Bilancet Financiare

Veprimet ekonomiko-financiare të Fondacionit fillojnë më datë 1 Janar dhe mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik, duke bërë përashtim për vitin e parë.

Neni 12
Përbërja e Organeve të Para Drejtuese

12.1 Anëtarë të Bordit Drejtues, janë:

- Elvis Naçi, themelues i Fondacionit.

- MUHARREM - Naçi

- Florion Beqiri

10 (njië qind miliard lekë) Lekë
garinë bankit të Kosovës
it nga kufizacioni i Kosovës



Neni 13
Dispozita tē fundit



13.1 Fondacioni "FIRDEUS" do tē ketē personalitetin e vet juridik qyshtetura dita e regjistrimit në gjykatë, sipas dispozitave ligjore në Republikën e Shqipërisë.

13.2 Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do tē zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar.

13.3 Mosmarrëveshjet lidhur me themelimin e Fondacionit zgjidhen me mirëkuptim, dhe kur kjo nuk arrihet, zgjidhen nga gjykata kompetente.


Ky Akt-Themelimi hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje me vlerë dhe fuqi të njëjtë.

Ky Akti i Themelimit dhe Statutit u firmosën nga Themeluesi.

THEMELUESI

Elvis NAÇI

Elvis Naçi



KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE

Tirane, më 6/6/2009

Nr.Prot. 0003

STATUTI I KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE (NDRYSHUAR)

Adresa: "Rruga Dhimitër Kamarda", Tirane, Shqipëri, Tel/Fax: +355 42355090 [email info@komunitetibektashi.org](mailto:info@komunitetibektashi.org)

STATUTI I
Kryegjyshatës Botërore Bektashiane
(ndryshuar)

Këshilli i Përgjithshem i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, i mbledhur sot, më 06/07/2009, nën drejtimin e Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve Haxhi Dede Reshat Bardhi, në perputhje të plotë me Statutin dhe meqenëse qendra e saj është në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me nenet 10 e 24 të Kushtetutës, Ligjin nr. 10 058, datë 22.01.2009 për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshatës Botërore Bektashiane për irregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta", Ligjin nr.10 140, date 15.05.2009 "Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Keshillin e Minsitrave", marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, si dhe ligjet e tjera në fuqi, pasi shqyrtoi rendin e dites,

Vendosi

Të bejë ndryshimet dhe plotesimet e nevojshme në Statutin e bashkësise fetare bektashian (Kryegjyshata Botërore Bektashiane), duke e riformular këtë Statut në përputhje me zhvillimet, parimet, interesat e saj dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,


si më poshtë vijon:

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Kryegjyshata Botërore Bektashiane, me seli në Tiranë, kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë, me adresë: rruga "Dimitër Kamarda", nr.10 Tiranë, është i përbërë nga komunitetet bektashiane dhe është tërësia e familjeve dhe individëve të kudondodhur në botë, të cilët mbajnë të ndezur në shpirtin e tyre besimin bektashian, duke adhuruar irregullat e shenja fetare, morale të bektashizmit.

Kryegjyshata Botërore Bektashiane, e përfaqesuar nga Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, gjëzon të drejten ligjore që të rivendoset të gjitha të drejtat e saj morale dhe pasurore të kudondodhura në Botë. Kleri dhe besimtaret bektashianë adhurojnë krijuesit e tyre, duke zbatuar doktrinën,



traditat, ritet fetare, morale, filozofike dhe duke e persosur atë ne vazhdimësi.

Respekton parimin e laicititetit, si dhe kushtetutat dhe legjislacionin përkatës në të gjitha vendet ku ushtrohet ky besim. Vendosja e Selisë së Shenjtë e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane në Tiranë është njojur me Vendimin nr.659, date 02.08.1930 të Këshillit të Ministrave të Mbretërisë Shqiptare dhe pas ndalimit të ushtrimit të fesë në vitin 1967, u rindoh në vitin 1993 në kongreset VI, VII dhe VIII, si edhe me Ligjin nr. 10 058, datë 22.01.2009 për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshatës Botërore Bektashiane për rrëgullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta".

Kryegjyshata Botërore Bektashiane është e organizuar në bazë të Statutit të saj dhe meqenëse e ka qendrën në Tiranë është regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 2

Kryegjyshata Botërore Bektashiane, komunitetet bektashiane te kudondodhura në botë kane në përbërje të tyre :

- Ashikë (dashamirës)
- Myhibe (besnikë)

Kleri bektashian, me në krye Kryegjyshin Botëror të Bektashinjve, ushtron besimin fetar islam me mesimet e Kuranit të Madhërueshem të pasuruara dhe te interpretuara me dijet dhe praktikat e Muhamet Aliut, Ehlibejtit te shenjtë dhe udhës se ndritur të Haxhi Bektash Veliut.

Neni 3

Gjuha zyrtare me të cilën komunitetet bektashiane ushtrojnë të drejtat e tyre fetare, është gjuha zyrtare e shtetit ku ata bëjnë pjesë.

Në rastet e komuniteteve bektashiane, që për arsyé të ndryshme ndodhen jashtë kufijve shtetërorë të vendit të tyre, ritet fetare mund të kryhen edhe në gjuhën amtare. Ndërsa në shtetet multietnike, ritet fetare kryhen në gjuhën amtare të shumicës së besimtarëve.

Neni 4

Njekohësisht, në ushtrimin e besimit fetar, me të njejtin përkushtim, nga bektashinjtë do te ushtrohet dhe zhvillohet atdhedashuria, morali, puna,

... Lecë A. Bektashi

dituria dhe vëllazeria në kuptimin më të mirë njerezor, ndërmjet të gjithë individeve, pa dallim të përkatësisë fetare, etnike, race, gjinie, bindjeje politike apo gjendjeje shoqërore.

Kryegjyshata Botërore Bektashiane, komunitetet bektashiane janë të panshme dhe dashamirse me të gjithë spektrin politik të lejuar nga legjislacionet në fuqi të vendëve respektive.

Ajo në veprimtarine e saj nuk lejon përkrahjen, propagandimin apo veprimtari politike në favor të asnje formacioni politik.

Neni 5

Dorëzimi, konsakrimi dhe gradimi i klerit bektashian të kudondodhur në Botë, bëhet sipas dogmës tradicionale fetare dhe në perputhje me ketë Statut.

Për çdo cilësi klerikale si më sipër, personi mbajtës, me dekret nga Kryegjyshi Boteror i Bektashinjve pajiset me uniformen fetare përkatëse.

Askush nuk mund të ushtrojë dhe gezojë cilesitë klerikale të bektashinjve në kundërshtim me këtë Statut dhe ligjin.

Neni 6

Kleri bektashian renditet sipas ofiqeve fetare sipas kësaj hierarkie :

1. Kryegjyshi Boteror i Bektashinjve - grada : Dede, Baba
2. Gjyshi - grada : Halife
3. Prindi - grada : Baba
4. Dervishi - grada : Dervish
5. Myhib - (praktikant i shkallës së parë të bektashizmit), shërbestar.

Neni 7

Kryegjyshata Botërore Bektashiane, komunitetet bektashiane, përkujtojnë ditë të shënuara ngajeta e shenjtorëve dhe udhëheqesve të mëdhenj themelues të bektashizmit, ceremoni kombëtare dhe ndërkombetare të njoitura, në pajtim me traditën, kalendarin vjetor bektashain dhe vendime apo dekrete të Kryegjyshit Botëror te Bektashinjve.

Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka keto dite te shenuara :

- Dita e Hashures muharrem, dita e dhjetë e zisë së Matemit, si ditë fatlume e Imamit të Shenjtë

H. Lecëtë Bektash.

- Dita e Nevruzit, ditëlindja e Imam Aiut
- Bajrami i Madh (Fitër Bajrami)
- Bajrami i Vogël (Kurban Bajrami)
- Ditë të shënuara dhe pelegrinazhe, sipas kalendarit vjetor bektashian
dhe festa të tjera islame.

Neni 8

Flamuri fetar i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane për ceremonitë publike është me fushë të gjelbër me teslimin të qarkuar nga degë dafine dhe në krahun tjetër flamuri i atij shteti ku bëjnë pjesë.

Flamuri fetar i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, për ceremonitë e brendshme, është me fushë të kuqe e stolisur me versete dhe porosi të zgjedhura hyjnore, në mes të së cilës ndodhet emblema e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane me dy shpatat e kryqëzuara të Imam Aliut.

Emblema e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, është Taxhi, i qarkuar nga Teslimi.

Vula e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane është rrethore, me mbishkrimin në formë harku në pjesën e sipërme: Selia e Shenjtë e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, Komuniteti Bektashian dhe në pjesën e poshtme Tiranë.

Vula e Gjyshatës është rrethore në formë harku në pjesën e sipërme: Selia e Shenjtë e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, Komuniteti Bektashain, Gjyshata..... (emri i gjyshatës).

Në shtetet ku janë të organizuar komunitete fetare bektashiane, vula do të ketë këtë mbishkrim: Selia e Shenjtë e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, komuniteti bektashian, poshtë emri i kryeqytetit të atij shteti.

E gjithë korrespondenca do të jetë vetëm me vulën e Selisë së Shenjtë të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane. Për korrespondencat brendapërbrenda Gjyshatës do të përdoret vula e Gjyshatës.

ORGANIZIMI, NENDARJET ADMINISTRATIVE DHE TITULLARET KLERIKALE

Neni 9

H. I - celi kth, ardh

Kryegjyshata Botërore Bektashiane me Selinë e Shenjtë në Tiranë, është qendra botërore e bektashinjve, terësia e komuniteteve fetare bektashiane nga e cila drejtohen.

Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve cilësohet kryeshenjtëri dhe si titullari më i lartë, i plotfuqishëm i komuniteteve bektashiane të kudondodhur, është udhëheqes shpirtëror fetar, administrativ dhe përfaquesues i ligjshëm kudo në Botë.

Gjyhatat varen nga Kryegjyshata Botërore me seli në Tiranë, ushtrojnë besimin fetar dhe janë ndarje administrative të percaktuara me dekret të Kryegjyshit Botëror.

Çdo Gjyhatë drejtohet nga një gjysh, në mungese nga një baba i dekretuar dhe vartës drejtpërdrejt i Kryegjyshit Botëror të Bektashinjeve. Ai është udhëheqes shpirtëror fetar administrativ dhe përfaquesuas i asaj gjyshate.

Prindëria (teqeja) është ndarje administrative e Gjyhatës, e cila drejtohet nga një prind (baba) i dekretuar nga Kryegjyshi Botëror dhe vartës i tij.

Dervishia është njësia me e vogël fetare, ku shërbejnë dervishët bektashiane. Çdo dervishie drejtohet nga një dervish, i dekretuar nga Kryegjyshi Botëror i Bektashinjeve. Në funksionet e tij fetare dhe administrative ai ka vartësi të drejtpërdrejtë nga prindi i teqesë dhe gjyshi i gjyhatës përkatëse.

Neni 10

Kryegjyshata Botërore Bektashiane, në kuptimin e territorit, sot ka këtë ndarje administrative, të dekretuar nga Kryegjyshi Botëror i Bektashinjeve:

Ne Republikën e Shqipërisë

(Meqënse në Shqipëri ndodhet Selia e Shenjtë e Kryegjyhatës) :

1. Gjyshata e Krujës, me seli në teqenë e Shën Memisë në Fushë Krujë, nën kompetencën tokësore të së cilës janë prinderitë e Durrësit, Matit, Bulqizës, Dibrës, Kurbinit, Kukësit, Tropojës dhe Krujës.
2. Gjyshata e Elbasanit, me seli në teqenë e Xhefai Babait, nën kompetencën tokësore të së cilës janë prindërite e Elbasanit, Gramshit, Librazhdit, Peqinit, Përrenjasit, Lushnjës dhe Kavajës.
3. Gjyshata e Beratit, me seli në teqenë e Tahir Babait, nën kompetencën tokësore të së cilës janë prinderitë e Beratit, Skraparit dhe Permetit.

S. Jelek Kavaja

4. Gjyshata e Korçës, me seli në teqenë e Turanit, nën kompetencën tokësore të së cilës janë prindërите e Korçës, Kolonjës, Devollit, Pogradecit dhe Leskovikut.

5. Gjyshata e Vlores, me seli në teqenë e Kuzum Babait, nën kompetencën tokësore të së cilës janë prindërите e Vlorës, Fierit, Patosit, Roskovecit dhe Mallakastrës.

6. Gjyshata e Gjirokastrës, me seli në teqenë e Asim Babait, nën kompetencen tokësore të së cilës janë prindërите e Gjirokastrës, Tepelenës dhe Sarandës.

Neni 11

Në Botë

- Komuniteti Bektashian i Kosovës, me seli në gjyhatën bektashiane të Gjakovës, në përberje të së cilës janë teqete bektashiane të Republikës së Kosovës

- Komuniteti Bektashian i Maqedonisë, me seli ne gjyhatën Harabati Baba, në përberje të së cilës janë të gjithë teqetë bektashiane që ndodhen në Republikën e Maqedonisë

- Komuniteti Bektashian i SHBA, Kanadasë, Australisë, me qendër ne gjyhatën e Detroitit në Miçigan të SHBA

- Komuniteti Bektashian i Turqisë, me qendër në Haxhi Bektash (sot muze)

- Teqetë bektashiane në Mal të Zi, Greqi, Bullgari, Rumani, Hungari, Bosnjë - Hercegovinë, Serbi, Egjipt, Iran, Irak etj., si dhe në vendet ku bektashizmi ka besimtarë dhe objekte kulti

Kurse në vendet e tjera të Botës, besimtarët bektashianë krijojnë bashkësitë e tyre, titullarët e të cilave dekretohen nga Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve.

Duke pasur parasysh diasporën dhe emigracionin ku ka përqendrime më të mëdha të bektashinjve, me propozim të tyre dhe vendim të posaçëm të Këshillit të Përgjithshëm të Kryegjyhatës, mund të krijohen kryesi për të drejtuar këto komunitete.

Neni 12

Grupimet e familjeve dhe individëve që ushtrojnë besimin fetar bektashian, të kudondodhura në Botë, janë pjesë e pandare e bashkësisë

H. Lekë Bora

fetare te komuniteteve bektashiane dhe mbajne lidhje te drejtperdrejte me Kryegjyhatën Botërore Bektashiane me seli në Tiranë.

Për çdo rast, në vartësi të numrit të besimtarëve, shtetit ku jetojnë, numrit të objekteve fetare dhe largësisë së tyre nga Selia e Shenjtë në Tiranë, për organizimin dhe udhëheqjen fetare të tyre Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve realizon grupimin në kuptimin e ndarjes administrative fetare dhe vendos me dekret posaçërisht përvartësinë tyre.

Neni 13

Bazuar në të drejten zakonore bektashiane dhe në traditën shekulllore, me kalimin e tyre ngajeta, klerikët bektashianë të çdo rangu, prehen në objektet e kultit ku kanë pasur kohën më të gjatë të shërbimit të tyre fetar.

Në rastet kur padrejtësish janë varrosur në varreza publike apo vende të tjera (në mënyrë të veçantë pas ndalimit të ushtrimit të lirisë fetare në vitin 1967, ne Shqiperi), klerikët dhe këshillat e gjyshatave bektashiane, në bashkëpunim me Selinë e Shenjtë të Kryegjyhatës Botërore Bektashiane dhe organet përkatëse të shtetit, organizojnë punën përvartimin e eshtrave të baballarëve dhe dervishëve.

Askush nga familjarët apo të afërmith nuk mund të gjëzojnë të drejtën përmbytjen e eshtrave të baballarëve dhe dervishëve.

Neni 14

Për kleriket bektashiane Dede, Baba, Dervish qe kane kaluar ngajeta, të cilet gjithçka ia kishin kushtuar rrugës së Haxhi Bektash Velut, te cilët perfitojnë në baze të ligjit përi ish të përndjekurit politikë, të afërmith e tyre (familjarët) nuk kanë të drejtë trashëgimie. Çdo përfitim monetar i takon Kryegjyhatës Botërore Bektashiane.

Neni 15

Kleri bektashian

Kleri Bektashian përbëhet nga:

1. Kleri myxheret jane ata klerike, të cilët nuk kanë qenë të martuar dhe kanë kryer ceremoninë e betimit të shenjtë të mosmartesës

2. Kleri myhteil jane ata klerike, të cilët janë shkëputur nga lidhja martesore dhe i nënshtronen të gjitha rregullave të brendshme në rrregulloret përkatëse.

3. Kleri myhteil mund të arrij deri në gradën baba.

Askush nga këta klerikë, qofshin myxheret, qofshin myhteil nuk kanë asnjë të drejtë të posedojn, ose të kryejnë transaksione të ndryshme me pronat e luajtshme dhe të paluajtshme të teqeve, prindërvive apo gjyshatave në të cilat shërbejnë.

Neni 16

Kujdesi për klerikët që ditën që ata bëjnë betimin e shenjtë, bëhet nga Selia e Shenjtë e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane dhe teqetë përkatëse (vendbanimi i tyre i përjetshëm), duke iu siguar atyre çdo gjë që u nevojitet për jetën si: strehimi, ushqimi dhe veshje sipas traditës bektashiane.

Neni 17

Kleri bektashian i çfarëdo rangu qoftë, për veprimet që cënojnë moralin fetar, si imoraliteti, vjedhja, veprimitari në dëm të Atdheut etj., përgjigjet detyrimisht përpara Këshillit Gjyshëror, si edhe para Këshillit të Përgjithshëm.

Në se fajet e tij vërtetohen me dokumente apo dëshmi të tjera, Këshilli i Përgjithshëm i paraqet Kryegjyshit Botëror propozim konkret për marrjen e masave sipas fajësise, deri në largimin nga rruga bektashiane.

Neni 18

Objektet e kultit të besimit bektashian të çfarëdo lloji (teqe, dervishie, tyrbe, mekam, vende të shenjta), administrohen nga gjyshatat, me autorizimin e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane.

Asnjë person, qoftë edhe në lidhje familjare, nuk ka të drejtë administrative mbi to pa lejen e gjyshatës ose Kryegjyshatës Botërore Bektashiane.

Neni 19

Të gjitha komunitetet fetare bektashiane jashtë territorit të Republikës së Shqiperisë, do te zbatojne me perpikmeri Statutin e Kryegjyshates Boterore Bektashiane.

Gjithashtu, për mbarëvajtjen e punëve fetare dhe administrative, komunitetet bazohen edhe në përgulloren e brendshme te hartuar prej tyre, në harmoni me Statutin e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane dhe të miratuar nga Selia e Shenjtë në Tiranë.

ORGANET VENDIMMARRESE DREJTUESE

Neni 20

Organet vendimmarrese drejtuese të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane në varesi të kompetencës tokësore të ushtrimit të pushtetit janë të ndara në organe qendrore dhe vendore.

Organet vendimmarrese drejtuese qendrore janë:


1. Kryegjyshi Botëror i Bektashinjeve, me seli në Tiranë
2. Këshilli i Lartë Gjyshëror
3. Kongresi i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane
4. Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Bektashian

Organet administrative qendrore janë:

- Sekretari i Përgjithshëm
- Departamenti i Kulturës
- Departamenti Juridik, Arkivi dhe Pronësia
- Departamenti i Kontroll - Financ - Auditit
- Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë
- Sekretari-Protokolli

Neni 21

Kryegjyshi Botëror i Bektashinjeve (duhet të jete patjetër myxheret dhe të ketë berë betimin e mosmartesës) është titullari më i lartë fetar dhe administrativ, përfaqesues i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane kudo në Botë, udhëheq të gjithe organet drejtuese vendimmarrese dhe për të gjitha rastet shprehet me dekret.



Ne rast se vendi i Kryegjyshit Botëror të Bektashinje mbetet vakant, Këshilli i Lartë Gjyshëror në bashkëpunim me Këshilli i Përgjithshëm, thërrasin mbledhje urgjente të Këshilli të Përgjithshëm, caktojnë kandidatët e mundshëm në bazë të parimeve bektashiane dhe ja paraqesin këto Kongresit të Jashtëzakonshëm. Ky organ me 2/3 e votive zgjedh kandidaturën më të mirë.

Delegatët zgjidhen nga e gjithë bota bektashiane. Delegatët duhet të janë myhibë dhe dashamirës te bektashizmit. Lista e delegatëve, përpara kongresit, kalon për miratim në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm.

Neni 22

Kryegjyshi Botëror i Bektashinjeve ndihmohet në punen e tij nga 2 këshilltare, dy gjyshër disponibël dhe Sekretari i Përgjithshëm, të cilët përzgjidhen personalisht nga Kryegjyshi Botëror dhe veprojne vetëm me porosi të Tij.

Neni 23


Kongresi i Kryegjyhatës Botërore Bektashiane ështe organi më i gjere ne kuptim të përfaqesimit dhe organi më i lartë, në përbërje të të cilët janë, perveç organeve drejtuese edhe delegatët nga e gjithë bota bektashiane. Ndërsa përfaquesues të komuniteteve të tjera fetare, të shtetëve, të botës akademike, mistike dhe shkencore janë në cilësinë e të ftuarit..

E gjithë veprimitaria hartohet, drejtohet, shpallet dhe njoftohet nga Këshilli i Përgjithshem, në përbërje të të cilët janë të gjithë përfaquesuesit e Këshillit të Lartë Gjyshëror, vendos për mjedisin se ku do te zhvillohet kongresi, protokollin e çdo personi fetar ose laik.

Kongresi i zakonshem thirret nga Kryegjyshi Botëror i Bektashinjeve, rregullisht çdo 5 vjet, kurse Kongresi i jashtëzakonshem thirret nga gjyshërit disponibël dhe Sekretari i Përgjithshem.

Kongresi fillon me: Himnin Kombëtar, për të shprehur doktrinen bektashiane "Pa Atdhe nuk ka fe". Çdo komunitet bektashian pjesëmarres në Kongres sjell me vete flamurin e atij shteti ku është vendosur ky komunitet.

Këshilli i Përgjithshëm miraton rendin e ditës për punimet e Kongresit Bektashian.



Neni 24

Veprimtaria fetare, arsimore, kulturore dhe shkencore

Komunitetet bektashiane të kudondodhura në Bote, mund të hapin shkolla të karakterit fetar, për perqatitjen e klerit bektashian. Dispozitat mbi organizimin dhe funksionimin e shkollave fetare dhe programeve shkollore, caktohen në bazë të legjislacionit mbi arsimin.

Me vendim te Këshillit të Përgjithshem dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore, Kryegjyshata Botërore Bektashiane mund të botoje libra, revista, broshura te ndryshme me përbajtje të dobishme rrëth besimit bektashian. Permbajtja e tyre nuk duhet të percjelle konflikte të natyrave të ndryshme dhe të irregullohet me një irregulllore të veçante të administrimit. Te gjitha botimet janë pasuri të Komunitetit Bektashian.

Selia e Shenjtë e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, miraton projektet për ndertim, restaurim, ndryshim të çdo lloj objekti kulti të besimit bektashian, të kudondodhura në Botë.

Neni 25

Këshilli i Përgjithshëm i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, si organi më i lartë administrativ dhe vendimmarrës, thirret dhe drejtohet nga Kryegjyshi Botërор i Bektashinjve dhe ka në përbërjen e tij 41 antarë. Çdo gjyhatë përfaqesohet me nga 2 përfaqesues, ndërsa Selia e Shenjtë e Kryegjyshatës Botërore Bektashaine ka 9 përfaqesues, Anëtaret e Këshillit të Përgjithshëm duhet të jenë njohës të mirë të rrugës dhe traditës bektashiane dhe të arsimuar. Këta dekretohen me dekret nga Kryegjyshi Botërор, me një mandat prej 5 vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 26

Këshilli i Përgjithshem thirret nga Sekretari i Përgjithshem, një herë në vit dhe për raste të jashtezakonshme mund të thirret 2 herë në vit. Ai drejtohet nga Kryegjyshi Botërор i Bektashinjeve dhe ndihmësit e tij fetarë dhe laikë. Ky Këshill ka keto kompetenca:

- Te marrë ne shqyrtim dhe të vendosë për të gjitha çeshtjet fetare dhe administrative të Kryegjyshates Boterore Bektashiane

- Te udhëzojë dhe të mbikqyrë veprimtarine fetare, ekonomike, administrative të Kryegjyhatës Boterore dhe të organeve vartëse të saj. Të gjitha gjyshatat duhet të depozitojnë prane sekretarisë së Kryegjyhatës Boterore Bektashiane raportin, 15 ditë përpara marrjes së njofimit për mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm.

- Të bëjë interpretimin e të gjitha neneve të Statutit dhe të rregullores së brendshme të administrimit të Kryegjyhatës Boterore Bektashiane.

- Te thërrasë Kongresin e radhës të Kryegjyhatës Boterore Bektashiane dhe të përcaktoje proceduren që duhet të ndiqet

- Të shqyrtojë dhe të miratojë buxhetin e komuniteteve bektashiane dhe të shqyrtojë raportin ekonomik, fetar, administrativ vjetor për të gjithë veprimtarine e Kryegjyhatës Boterore Bektashiane.

Rendi i ditës i mbledhjes së Keshillit të Pergjithshem, si dhe materiali përkatës, u dergohet të gjithe anëtareve, 15 dite përpara mbledhjes.

Neni 27

Keshilli i Larte Gjyheror eshte organi me i lartë që kryesoitet nga Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve dhe në përberjen e tij janë të gjithë ofiqarët titullare të gjyshatave dhe klerikët më të lartë të teqeve kudo ne Botë.

Ky organ thirret nga Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, sa herë që të shihet e arsyeshme prej Tij.

Neni 28

Keshilli i Larte Gjyheror ka te drejtë dhe detyre ne misionin e tij :

- Te mbajë lart unitetin dogmatik dhe kanonik të bektashinjve të kudondodhur në Botë.

- Të bashkërendojë marrëdhieniet vëllazerore ndërfetare.

- Te kontrollojë të gjithë klerin bektashian për nivelin e predikimit, të ruajtjes dhe kultivimit të virtuteve morale më të mira.

- Te hartojë platforma afatmesme dhe afatgjata për zhvillimin e mëtejshëm të bektashizmit dhe rritjes numerike të myhibëve dhe dashamirësve.

✓, Jashkën këtë mënyrë

Neni 29

Këshilli i Lartë Gjyshëror dhe Keshilli i Pergjithshëm marrin në shqyrtim dhe propozojne përpara Kryegjyshit Botëror të Bektashinjeve, i cili vendos me dekret per :

- Ndarjen administrative fetare dhe vartësine klerikale bektashiane, të çdo objekti kulti fetar bektashian kudo në Botë.
- Kleriket, për dekretimin me ngritje apo ulje ne detyre, tituj nderi, masat disiplinore deri në zhveshjen e tyre etj.

Neni 30

Gjyshi ose babai i gjyhatës emërohet dhe shkarkohet nga Kryegjyshi Botëror Bektashian dhe raporton para tij për të gjitha problemet.

Gjyshi ose babai i gjyhatës ka këto kompetenca :

Të administrojë dhe të drejtojë gjyhatën nga pikëpamja fetare dhe administrative, në përputhje me dogmat bektashiane dhe legjislacionin në fuqi.

Të zbatoje vendimet e organeve qëndrore.

Të mirëadministroje pasurinë e gjyhatës dhe të kryeje veprime qe janë vetem në dobi të saj. Të gjitha pasuritë e patundshme do të regjistrohen si pasuri e Kryegjyhatës Botërore Bektashiane dhe jo në emërin e tij vetiak.

Të inspektojë, të kontrollojë dhe të udhezoje prindëritë dhe dervishiet që ka në vartësi.

Të paraqesë organikën për miratim nga Kryegjyshi Botëror i Bektashinjeve.

Të kryejë dhe të japë udhezime për sherbesat fetare dhe të dorezojë dervishë sipas rregullave kanonike fetare.

Perfaqeson gjyhatën pranë autoriteteteve vendore ose të delegojë persona të tjera.

Gjyshi i gjyhatës ose babai ndihmohet në punën e tij nga një sekretar, i cili ka varësi nga gjyshi i zonës ose nga babai i gjyhatës dhe Sekretari i Përgjishëm.

Prindërit dhe dervishët titullarë

Prindërit dhe dervishët janë respektivisht titullarët e prinderisë dhe dervishisë.

Zgjedhja e prindërit bëhet me propozimin e myhibeve të teqesë, të cilët propozimin e paraqesin me shkresë gjyshatës dhe me miratimin e Selisë së Shenjtë të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane nga e cila varet prindëria.

Prindërit dhe dervishët titullarë kanë këto detyra :

Të drejtojne fetarisht dhe administrativisht prindëritë dhe dervishiet në misionin e tyre fetar.

Të zbatojnë vendimet e organeve qendrore dhe të këshillave përkatëse të prindërive dhe dervishive.

Të përfaqesojë prinderite dhe dervishiet pranë autoriteteve vendore në veprimtaritë civile dhe administrative, duke marrë leje nga gjyshi ose babai i gjyshatës.

Te administroje pasurinë e teqeve dhe teë ruaje traditen e bujarisë që karakterizon besimin bektashian.

Neni 31

Këshilli klerikal i gjyshatës përbehet nga gjyshi drejtues dhe nga ndihmësit e tij baballarë.

Ky organ mblidhet rregullisht, çdo muaj, nga gjyshi ose babai i gjyshatës.

Në rastet kur mund të shfaqen probleme të ndryshme. Këshilli thirret edhe nga Kryegjyshi Botëror i Bektashainje dhe raporton përpara Tij.

Mbledhja e Këshillit Klerikal të gjyshatës është e ligjshme kur janë të pranishëm 2/3 e anëtareve.

Administrimi i pronave dhe financat

Neni 32

Të gjitha pasuritë që i përkasin Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, gjyshatat, prinderitë, tejetë dhe dervishiet, të kudondodhura në Bote, përbejnë pasurite e komuniteteve bektashiane. Të gjitha teqete, objektet e kultit fetar dhe pasuritë e paluajtshme të kudondodhura në Botë, të njoitura ligjërisht si prona të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, do të regjistrohen

H. Lekë Dukagjini

si pasuri e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane dhe të komuniteteve bektashiane të kudondodhura.

Për rastet e mosmarrëveshjeve apo qendrimeve të personave të tretë fizike e juridike apo shtet qofshin, kundër interesave dhe te drejtave pasurore të Kryegjyshates Botërore Bektashiane, Selia e Shenjtë ndërmerr veprimet e nevojshme për zgjidhjen e këtyre, me pajtim gjyqësor, para gjykatave te zakonshme kombëtare të shteteve përkatëse, deri ne gjykatat ndërkombëtare.

Neni 33

Te ardhurat e komunitetit bektashian jane:

- Të ardhurat nga mirëadministrimi i pasurisë.
- Të ardhurat nga ndihmat e besnikëve dhe dashamirësve.
- Subvencione pa interes.
- Të ardhurat nga teqetë, tyrbet dhe mekamet.
- Dhurata të ndryshme.

Neni 34

Shpenzimet e komunitetit bektashian jane:

- Shpenzimet për ushtrimin e besimit fetar bektashian.
- Shpenzime për ushqime dhe veshmbathje.
- Shpenzime për rroga dhe shpërblime.
- Shpenzime për ceremonitë fetare.
- Shpenzime për veprimtari të ndryshme, kongrese, simpoziume, përkujtimore, udhëtime, për investime, ndihma për teqetë që nuk kanë të ardhura, mirëmbajtje, riparime.
- Shpenzimet për ndihmat për persona, komunitete fetare, jofetare, shpenzime për botime, shkolla etj.

Neni 35

Të gjitha gjyhatat apo ndarjet administrative bektashiane të varura drejtpërsedrejti nga Selia e Shenjtë e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, kanë detyrim të përmbyshin urdhërimet e Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, për të kaluar në të mirë të buxhetit të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane 25% të të ardhurave financiare mujore.

Neni 36

Pasuritë e Kryegjyshatës Botërore Bektashaine ndahen në të luajtshme dhe të paluajtshme dhe janë terësia e vlerave që kjo bashkësi fetare i ka fituar me trashëgim apo nepërmjet formave ligjore të parashikuara në parimet e përgjithshme të marrëdheneve civile dhe normat e marrëveshjet ndërkombetare përgjithesisht të pranuara.

Neni 37

Të gjitha pasuritë në marrëdhieniet civile pasurore do të rregullohen nga legjislacioni në fuqi i shtetit përkatës ku ato ndodhen, duke respektuar zakonet e mira të atij shteti, atij komuniteti apo asaj ndarjeje administrative.

Neni 38

Të gjitha pasuritë e luajtshme do t'i nënshtronen evidentimit, regjistrimit, kontabilizimit dhe mireadministrimit nga komisioni ekonomik nen drejtimin e të ngarkuarit specialist, i cili raporton rregullisht përpara Kryegjyshit Botëror të Bektashinjeve.

Neni 39

Pasuritë e paluajtshme të komuniteti bektashian ndahen në:

- Pasuri të paluajtshme të shenjta.
- Pasuri të paluajtshme të zakonshme.

Pasuritë e paluajtshme të shenjta janë objektet ndërtimore fetare dhe trojet në to, të cilet sherbejnë për ushtrimin e veprimtarive dhe riteve fetare. Keto janë të shenjta dhe të patjetersueshme.

Neni 40

Pasuritë e paluajtshme të zakonshme janë të gjithe trojet dhe objektet ndërtimore mbi to, pemishtet, ullishtet, vreshtat, livadhet, kullotat, pyjet, tokat bujqësore në pronësi të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, të cilat i ka fituar me trashëgim apo me secilën nga menyrat e parashikuara në ligjet përkatëse. Ndryshimi i regjimit juridik, shitja, dhënia me qera, dhënia për



ndërtim e pasurisë të palujtshme të zakonshme në të mirë të interesave të Kryegjyhatës Botërore Bektashiane bëhet vetëm nga kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, pas konsultimeve që ky ndërrmer me Këshillin e Lartë Gjyshëror, këshilltarët dhe stafin e tij. Pasuritë e Kryegjyhatës Botërore Bektashiane janë pasuri që ngelen në pronësi dhe trashëgim të komunitetit fetar. Asnjë klerik nuk mund të bejë tjetësimin e asnjë lloj pasurie në emrin e vet, të familjarëve të vet apo të ndonjë personi tjetër.

Dispozita tranzitore

Neni 41

Ky Statut u hartua në bazë të dogmave dhe traditave të larta bektashiane, është në përputhje me zakonet e mira dhe nuk bie ndesh me Kushtetutën dhe kuadrin ligjor.

Neni 42

Kryegjyshata Botërore Bektashiane respekton fuqinë e ligjit, normat rregulluese, marrëveshjet ndërkombetare që marrin në mbrojtje liritë dhe të drejtat themelore të njeriut botërisht të pranuara, dhe meqenëse Selia e saj është në Republikën e Shqipërisë, nenet 10 e 24 të Kushtetutës, Ligjin nr. 10 058, datë 22.01.2009 për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyhatës Botërore Bektashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta", Ligjin nr.10 140, date 15.05.2009 "Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Minsitrave",

Neni 43

Në bazë të neneve të këtij Statuti, Selia e Shenjtë e Kryegjyhatës Botërore Bektashiane, harton rregullore të brendshme për gjyshatat brenda dhe jasht territorit te Republikes se Shqiperise.

Gjithashtu mbi bazën e këtij Statuti hartohen rregulloret e tjera përkatese, të cilat miratohen nga Selia e Shenjtë.

Neni 44

Me propozimin e Kryegjyshit Botëror të Bektashinjeve dhe me miratim të Këshillit të per gjithshem , ky Statut mund të pësojë ndryshime, vetëm kur këto ndryshime nuk bien ndesh me rrugën dhe traditën bektashiane . Ndryshimet pas miratimit nga keshilli I per gjithshem kalojne per miratim ne kongresin e radhes te Kryegjyshates Boterore Bektashiane.


Dispozita perfundimtare

Neni 45

Për gjithçka që nuk është parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

KRYEGJYSHI BOTËROR I BEKTASHINJEVE

HAXHI DEDE RESHAT BARDHI





NUMRI SERIAL:
1008149000

ÇERTIFIKATE REGJISTRIMI

Personit të Tatueshëm:

KOMUNITETI BEKTASHIAN

Me adresë kryesore:

Rr. DHIMITER KOMADRA Nr. 10
TIRANE

I jepet ky numër identifikimi (NIPT):

J816060020

DATA E LËSHIMIT
28/05/2008

DEGA E TATIMEVE

M. D. V. A. N. C. Q. N. D.
(Emri Mbiesqiri)

Kjo çertifikatë mbeten pronë e Ministrisë se Financave dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë denaj ose ndërprihet deyrimi ligjor për të qënë person i tatuveshëm.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
NR. 4760/.....VENDIMI



VENDIM
PËR REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, më datë 27.12.2009, unë Gjyqtare e Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë, Maryana Bajrami, pasi mora në shqyrtim kërkesën e kërkuar nga Xhelaj, i cili kërkon të regjistrojë ndryshimet ne Statutin e Bashkesise Fetare "Komuniteti Bektashian", si dhe te depozitoje Statutin e ri te ndryshuar te kesaj Bashkesie Fetare,

KONSTATOVA

Se, kërkuesi kërkon të regjistrojë ndryshimet ne Statutin e Bashkesise Fetare "Komuniteti Bektashian" te miratuara me Vendimin Nr.112 date 06.07.2009 te Keshillit te Pergjithshem te Bashkesise Fetare "Komuniteti Bektashian", si dhe te beje depozitim i statutit te ri me ndryshimet, te cilat janë si vijon:

1. Ndryshohet emri i Bashkesise Fetare "Komuniteti Bektashian" nga: Bashkesia Fetare e "Komunitetit Bektashian" ne: Kryegjyshata Boterore Bektashiane;
2. Riformulohet neni 3 i statutit sipas permbytjes se tij ne statutin e ri;
3. Rishikohen emertimet e ofiqeve fetare te klerit bektashian ne nenin 6 te statutit;
4. Shtohen si festa fetare ne nenin 7: Bajrami i Madh, Bajrami i Vogel dhe Ditë të shënuara dhe pelegrinazhe, sipas kalendarit vjetor bektashian dhe festa të tjera islame;
5. Ne nenin 8 te statutit ndryshohet flamuri i Kryegjyshates Boterore Bektashiane per ceremonite publike, duke u zevendesuar me: Flamuri fetar i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane për ceremonitë publike është me fushë të gjelbër me teslimin të qarkuar nga degë dafine dhe në krahun tjetër flamuri i atij shteti ku bëjnë pjesë, si dhe ndryshon vula e Kryegjyshates dhe ajo e Gjyshates dhe e komuniteteve te tjera fetare bektashiane neper bote. Gjithashtu percaktohet vula e korrespondences;
6. Ne nenin 9 te Statutit shtohet: drejtimi i Gjyshates nga një baba i dekretuar dhe vartes i drejtperdrejtë i Kryegjyshit Boteror te Bektashinjve ne mungëse te një gjyshi; Ndryshon varesia e Dervishit, e cila tashme eshte ne varesine e prindit te teqeze dhe gjyshit te gjyshates perkatese;
7. Ne nenin 10 ndryshohet ndarja administrative fetare e Komunitetit Bektashian duke shtuar Gjyshaten e Tiranes me seli ne Tirane, nen kompetencen tokesore te se ciles janë prinderit e Tiranes, Durrësit dhe Kavajes;
8. Pas nenit 10 shtohet neni 11:(i ri) ku percaktohen ndarja administrative e Komuniteteve Beshtashiane neper Bote, me permbytjen sipas nenit 11 te statutit te ri;
9. Neni 12 i statutit te vjetër hiqet;
10. Shtohen nenet 13-19 (duke i perfshire keto 2 numra) sipas permbytjes se ketyre neneve te statuti i ri;
11. Neni 13 i statutit te vjetër behet neni 20 i statutit te ri dhe ndryshohet duke shtuar 6 organet administrative qendrore: - Sekretari i Përgjithshëm, - Departamenti i Kulturës, - Departamenti Juridik, Arkivi dhe Pronësia, - Departamenti i Kontroll - Finance – Auditit, -Departamenti i Marrëdhënive me Jashtë, - Sekretari-Protokolli
12. Neni 14 i statutit te vjetër behet neni 21 i statutit te ri dhe ndryshohet sipas permbytjes se ketij neni ne statutin e ri. Perkatesisht ndryshon menyra e vendimarrjes se Kryegjyshit Boteror, e cila tashme behet vetem me dekret, si dhe emerimi i tij, qe tashme behet nga Keshilli i Pergjithshem;

13. Ndryshohet permbajtja e nenit 15 te statutit te vjeter sipas permbajtjes se nenit 22 te statutit te ri duke shqip 2 keshilltare qe e ndihmojne Kryegjyshin Boteror te Bektashinjve ne punen e tij dhe duke hequr paragrafin e dyte te nenit 15 te statutit te vjeter;
14. Ndryshohet nene 16 dhe 17 te statutit te vjeter duke u riformuluar ne nenin 23 te statutit te ri, ku ~~ndryshohet~~ kompetence me e gjere Keshillit te Pergjithshem te Kryegjyshates Boterore Bektashiane;
15. Ndryshohet neni 18 i statutit te vjeter, i cili riformulohet ne nenin 24 te statutit te ri, duke percaktuar numrin e anetareve, mandate, menyra e zgjedhjes se tyre dhe perberja e Keshillit te Pergjithshem te Kryegjyshates Boterore Bektashiane si organi me i larte administrativ dhe vendimmarres;
16. Ndryshohet neni 19 i statutit te vjeter, i cili riformulohet ne nenin 25 te statutit te ri, duke percaktuar menyren e mbledhjes dhe kompetencat e Keshillit te Pergjithshem te Kryegjyshates Boterore Bektashiane;
17. Ndryshohet neni 20 i statutit te vjeter, i cili riformulohet ne nenin 26 te statutit te ri;
18. Ndryshohet neni 21 i statutit te vjeter, i cili riformulohet ne nenin 27 te statutit te ri, duke hequr nga kompetencat e Keshillit te Larte Gjysheror: - zbatimin, interpretimin dhe ndryshimin e Statutit, si dhe kontrollin mbi administraten dhe financat;
19. Ndryshohet neni 22 i statutit te vjeter, i cili riformulohet ne nenin 28 te statutit te ri;
20. Neni 23 i statutit te vjeter hiqet;
21. Nenet 24, 25, 26, 28 & 29 te statutit te vjeter ndryshohen dhe shkrihen duke u riformuluar ne nenin 29 te statutit te ri, duke percaktuar klerin fetar lokal: gjysh, prind dhe dervish titullar, menyren e emerimit dhe kompetencat e tyre;
22. Neni 27 i statutit te vjeter riformulohet ne nenin 30 te statutit te ri;
23. Neni 30 i statutit te vjeter hiqet;
24. Shtohet neni 31 i statutit te ri me titull: "Veprimtaria fetare, arsimore, kulturore dhe shkencore";
25. Ndryshohet neni 31 dhe 32 i statutit te vjeter, duke u riformuluar ne nenin 32 te statutit te ri;
26. Ndryshohet neni 33 i statutit te vjeter ne nenin 33 te statutit te ri duke shtuar si te ardhura te komunitetit bektashian edhe: - Te ardhurat nga teqete, tyrbet dhe mekamet, dhe Dhurata te ndryshme;
27. Riformulohet neni 34 i statutit te vjeter ne nenin 34 te statutit te ri;
28. Riformulohet neni 35 i statutit te vjeter ne nenin 35 te statutit te ri, duke percaktuar perqindjen prej 25% te te ardhurave financiare te gjyhatave apo ndarjeve administrative bektashiane qe kalojne ne buxhetin e Kryegjyshates Boterore Bektashiane;
29. Neni 38 i statutit te vjeter ndryshohet ne nenin 38 te statutit te ri, duke percaktuar titullarin klerik tek i cili raportohet per mireadministrimin e pasurise: Kryegjyshin Boteror te Bektashinjve;
30. Hiqen nenet 39 & 40 te statutit te vjeter;
31. Neni 41 i statutit te vjeter ndryshohet ne nenin 39 te statutit te ri duke hequr paragrafin e fundit te nenit 41 te statutit te vjeter;
32. Neni 42 i statutit te vjeter ndryshohet ne nenin 40 te statutit te ri, sipas permbajtjes se ketij te fundit;
33. Hiqet neni 43 i statutit te vjeter;
34. Neni 44 i statutit te vjeter behet neni 41 i statutit te ri;
35. Neni 45 i statutit te vjeter ndryshohet ne nenin 42 te statutit te ri, sipas permbajtjes se ketij te fundit;
36. Neni 46 i statutit te vjeter ndryshohet ne nenin 43 te statutit te ri, sipas permbajtjes se ketij te fundit;
37. Neni 47 i statutit te vjeter ndryshohet ne nenin 44 te statutit te ri, sipas permbajtjes se ketij te fundit, duke percaktuar Keshillin e Pergjithshem te Kryegjyshates Boterore te Bektashinjve si organin kompetent per ndryshimin e Statutit;
38. Neni 48 i statutit te vjeter hiqet;
39. Shtohet neni 45 i statutit te ri me permbajtjen sipas percaktimit ne statutin e ri.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të Nenit 39 e vijues te K.Civil, Ligjt 8781 date 03.05.2001, Ligjt 8788 date 07.05.2001
dhe Ligjt 8789 date 07.05.2001

VENDOSA

- Pranimin e kërkesës.
- Registrimin e Vendimit Nr.112 date 06.07.2009 te Bashkesia Fetare "Komuniteti Bektashian", me te cilit Keshilli i Pergjithshem i kesaj Bashkesie Fetare ka miratuar ndryshimet ne Statutin e Bashkesise Fetare « Komuniteti Bektashian »;
- Depozitimin e Statutit te ri te Kryegjyshates Boterore Bektashiane me ndryshimet si vijon :
1. Ndryshohet emri i Bashkesise Fetare "Komuniteti Bektashian" nga: Bashkesia Fetare e "Komunitetit Bektashian" ne: Kryegjyshata Boterore Bektashiane;
 2. Riformulohet neni 3 i stafutit sipas permbajtjes se tij ne statutin e ri;
 3. Rishikohen emertimet e ofiqeve fetare te klirit bektashian ne nenin 6 te statutit;
 4. Shtohen si festa fetare ne nenin 7: Bajrami i Madh, Bajrami i Vogel dhe Ditë të shënuara dhe pelegrinazhe, sipas kalendarit vjetor bektashian dhe festa të tjera islame;
 5. Ne nenin 8 te statutit ndryshohet flamuri i Kryegjyshates Boterore Bektashiane per ceremonite publike, duke u zevendesuar me: Flamuri fetar i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane për ceremonitë publike është me fushë të gjelbër me teslimin të qarkuar nga degë dafine dhe në krahun tjetër flamuri i atij shteti ku bëjnë pjesë, si dhë ndryshon vula e Kryegjyshates dhe ajo e Gjyshates dhe e komuniteteve te tjera fetare bektashiane neper bote. Gjithashtu percaktohet vula e korrespondences;
 6. Ne nenin 9 te Statutit shtohet: drejtimi i Gjyshates nga një baba i dekretuar dhe vartes i drejtperdrejtë i Kryegjyshit Boteror te Bektashinjve ne mungese te një gjyshi; Ndryshon varesia e Dervishit, e cila tashme eshte ne varesine e prindit te teqese dhe gjyshit te gjyshates perkatese;
 7. Ne nenin 10 ndryshohet ndarja administrative fetare e Komunitetit Bektashian duke shtuar Gjyshaten e Tiranes me seli ne Tirane, nen kompetencen tokesore te se ciles jane prinderit e Tirapes, Durrësit dhe Kavajes;
 8. Pas nenit 10 shtohet neni 11 (i ri) ku percaktohen ndarja administrative e Komuniteteve Beshtashiane neper Bote, me permbajtjen sipas nenit 11 te statutit te ri;
 9. Neni 12 i statutit te vjeter hiqet;
 10. Shtohen nenet 13-19 (duke i perfshire keto 2 numra) sipas permbajtjes se ketyre neneve te statuti i ri;
 11. Neni 13 i statutit te vjeter behet neni 20 i statutit te ri dhe ndryshohet duke shtuar 6 organet administrative qendrore: - Sekretari i Përgjithshëm, - Departamenti i Kulturës, - Departamenti Juridik, Arkivi dhe Pronësia, - Departamenti i Kontroll - Finance – Auditit, -Departamenti i Marrëdhënive me Jashtë, - Sekretari-Protokolli;
 12. Neni 14 i statutit te vjeter behet neni 21 i statutit te ri dhe ndryshohet sipas permbajtjes se ketij neni ne statutin e ri. Perkatesisht ndryshon menya e vendimarrjes se Kryegjyshit Boteror, e cila tashme behet vetem me dekret, si dhe emerimi i tij, qe tashme behet nga Keshilli i Pergjithshem;
 13. Ndryshohet permbajtja e nenit 15 te statutit te vjeter sipas permbajtjes se nenit 22 te statutit te ri duke shtuar 2 keshilltare qe e ndihmojne Kryegjyshin Boteror te Bektashinjve ne punen e tij dhe duke hequr paragrin e dyte te nenit 15 te statutit te vjeter;
 14. Ndryshohen nenet 16 dhe 17 te statutit te vjeter duke u riformular ne nenin 23 te statutit te ri, ku i jepet kompétence me e gjere Keshillit te Pergjithshem te Kryegjyshates Boterore Bektashiane;
 15. Ndryshohet neni 18 i statutit te vjeter, i cili riformulohet ne nenin 24 te statutit te ri, duke percaktuar numrin e anetareve, mandate, menya e zgjedhjes se tyre dhe perberja e Keshillit te Pergjithshem te Kryegjyshates Boterore Bektashiane si organi me i larte administrativ dhe vendimmarres;

- CITERIS
- SHTATUTIT TE VJETER
16. Ndrysuhet nenii 19 i statutit te vjeter, i cili riformulohet ne nenin 25 te statutit te ri, duke percaktuar menyren e mbledhjes dhe kompetencat e Keshillit te Pergjithshem te Kryegjyshates Boterore Bektashiane;
 17. Ndrysuhet nenii 20 i statutit te vjeter, i cili riformulohet ne nenin 26 te statutit te ri;
 18. Ndrysuhet nenii 21 i statutit te vjeter, i cili riformulohet ne nenin 27 te statutit te ri, duke hequr nga kompetencat e Keshillit te Larte Gjysheror: - zbatimin, interpretimin dhe ndryshimin e Statutit, si dhe kontrollin mbi administraten dhe financat;
 19. Ndrysuhet nenii 22 i statutit te vjeter, i cili riformulohet ne nenin 28 te statutit te ri;
 20. Neni 23 i statutit te vjeter hiqet;
 21. Nenet 24, 25, 26, 28 & 29 te statutit te vjeter ndryshohen dhe shkrihen duke u riformuluar ne nenin 29 te statutit te ri, duke percaktuar klerin fetar lokal: gjysh, prind dhe dervish titullar, menyren e emerimit dhe kompetencat e tyre;
 22. Neni 27 i statutit te vjeter riformulohet ne nenin 30 te statutit te ri;
 23. Neni 30 i statutit te vjeter hiqet;
 24. Shtohet nenii 31 i statutit te ri me titull: "Veprimtaria fetare, arsimore, kulturore dhe shkencore";
 25. Ndrysuhet nenii 31 dhe 32 i statutit te vjeter, duke u riformuluar ne nenin 32 te statutit te ri;
 26. Ndrysuhet nenii 33 i statutit te vjeter ne nenin 33 te statutit te ri duke shtuar si te ardhura te komunitetit bektashian edhe: - Te ardhurat nga teqetë, tyrbet dhe mekamet, dhe Dhurata te ndryshme;
 27. Riformulohet nenii 34 i statutit te vjeter ne nenin 34 te statutit te ri;
 28. Riformulohet nenii 35 i statutit te vjeter ne nenin 35 te statutit te ri, duke percaktuar perqindjen prej 25% te te ardhurave financiare te gjyhatave apo ndarjeve administrative bektashiane qe kalojne ne buxhetin e Kryegjyshates Boterore Bektashiane;
 29. Neni 38 i statutit te vjeter ndrysuhet ne nenin 38 te statutit te ri, duke percaktuar titullarin klerik tek i cili raportohet per mireadministrimin e pasurise: Kryegjyshin Boteror te Bektashinje;
 30. Hiqen nenet 39 & 40 te statutit te vjeter;
 31. Neni 41 i statutit te vjeter ndrysuhet ne nenin 39 te statutit te ri duke hequr paragrafin e fundit te nenit 41 te statutit te vjeter;
 32. Neni 42 i statutit te vjeter ndrysuhet ne nenin 40 te statutit te ri, sipas permbajtjes se ketij te fundit;
 33. Hiqet nenii 43 i statutit te vjeter;
 34. Neni 44 i statutit te vjeter behet nenii 41 i statutit te ri;
 35. Neni 45 i statutit te vjeter ndrysuhet ne nenin 42 te statutit te ri, sipas permbajtjes se ketij te fundit;
 36. Neni 46 i statutit te vjeter ndrysuhet ne nenin 43 te statutit te ri, sipas permbajtjes se ketij te fundit;
 37. Neni 47 i statutit te vjeter ndrysuhet ne nenin 44 te statutit te ri, sipas permbajtjes se ketij te fundit, duke percaktuar Keshillin e Pergjithshem te Kryegjyshates Boterore te Bektashinje si organin kompetent per ndryshimin e Statutit;
 38. Neni 48 i statutit te vjeter hiqet;
 39. Shtohet nenii 45 i statutit te ri me permbajtjen sipas percaktimit ne statutin e ri.

- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

- Kuridër vendimit lejohet ankim sipas ligjit.




REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
ZYRA E REGISTRIT TE OJF-ve

Tirane, me 07.07.2021

VERTETIM

KRYEGJYSHATA BOTEROBE BEKTASHIANE

Me vendimin nr.4760, dt.19.09.1997 te Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tirane eshte vendosur rregjistrimi si person juridik i shoqates Komuniteti Bektashian Shqiptar; me seli ne rr. Ali Demi, Tirane; shoqata ka per objekt veprimitarie me qellime fetare njojen e perkrahjen dhe zhvillimin e ndjenjave dhe kultures fetare te sektit Bektashian, etj.; organet drejtuese te shoqates jane Keshilli i Pergjithshem i komunitetit, Keshilli i larte gjyshor, Keshillat e gjyshatave, Keshillat prinderore, Keshillat e Dervishlereve; Kryegjyshi boteror i Bektashinjve eshte Haxhi Dede Reshat Bardhi, Sekretar i pergjithshem eshte Tomor Aliko, sekretar teknik eshte Kujtim Ahmetaj, Drejtor ekonomik dhe financiar eshte Hysen Beahimaj.

Me vendimin nr. 4760/1 date 22.12.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur pranimin e kerkeses per rregjistrimin e vendimit nr. 112, date 06.07.2009 te Bashkesia Fetare Bektashiane, me te cilin Keshilli i Pergjithshem i kesaj Bashkesie Fetare ka miratuar ndryshimet ne statutin e shoqates, depozitim e statutit te ri me ndryshimet si vijon: Ndryshohet emri i Bashkesise Fetare "Komuniteti Bektashian" nga Bashkesia Fetare Komuniteti Bektashian ne Kryegjyshata Boterore Bektashiane; shtohen si festa fetare ne nenin⁷: Bajrami i Madh, Bajrami i Vogel dhe Dite te shenuara dhe pelegrinazhe, sipas kalendarit vjetor bektashian dhe festa te tjera islame; ne nenin 10 ndryshohet ndarja administrative fetare e Komunitetit Bektashian duke shtuar Gjyshaten e Tiranes me seli ne Tirane; nenin 13 i statutit te vjeter behet nenin 20 i statutit te ri dhe ndryshohet duke shtuar 6 organet administrative qendrore:-Sekretari i Pergjithshem, - Departamenti i Kultures, - Departamenti Juridik, Arkivi dhe Pronesia, -Departamenti i Kontroll -Finance-Auditit, - Departamenti i Maredhenieve me Jashte, -Sekretare-Protokoll; ndryshohet nenin 18 i statutit te vjeter i cili riformulohet nenin 24 te stutit te ri, duke percaktuar numrin e anetareve, mandate, menyra e zgjedhjes se tyre dhe perberja e Keshillit te Pergjithshem te Kryegjyshates Boterore Bektashiane si organi me i larte administrativ dhe vendimmarres; ndryshohet nenin 19 i statutit te vjeter i cili riformulohet ne nenin 25 te statutit te ri, duke percaktuar menyren e mbledhjes dhe kompetencat e Keshillit te Pergjithshem te Kryegjyshates Boterore Bektashiane; etj.



Me vendim nr. 4760/2 date 19.04.2012 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vendosur depozitimi i vendimit date 23.07.2011 ne te cilin eshte vendosur: Miratimi i vendimit te Keshillit te Larte gjysheror dhe atij klerik te dates 11.06.2011 dhe te zgjedhe si Kryegjysh Boteror te Bektashinjve Haxhi Baba Edmond Brahimaj (ne postin e mbetur vacanti te te ndjerit Haxhi Dede Reshat Bardhi). Haxhi Baba Edmond Brahimaj eshte i vjetmi perfaqesues ligjore i Selise se shenjte te Kryegjyshates Botrore Bektashiane.

Ndryshime te metejshme nuk ka.

SEKRETARE E REGISTRIT TE OFRISË

Besa KORBECI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr.4760/2 Vendimi

VENDIM
I GJYQTARIT TE VENDIM

Ne Tirane, sot, me date 29/07/2012, ne Gjyqtare e Gjkates se Rrethit Gjyqesor Tirane Rezarta Balliu(Vigani), mora ne shqyrtim Kerkesen dhe Aktet e paraqitura, nga Vadiola Muço, me cilesine e perfaqesues te 'Kryegjyshates Boterore Bektashiane', dhe

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr.extra prot date 23.07.2011 eshte vendosur:

'Miratimi i vendimit te Keshillit te Larte gjyshelor dhe atij klerik te dates 11.6.2011 dhe te zgjedhe si Kryegjysh Boteror te Bektashinje Haxhi Baba Edmond Brahimaj(ne postin e mbetur vakant te te ndjerit Haxhi Dede Reshat Bardhi). Haxhi Baba Edmond Brahimaj eshte i vetmi perfaqesues ligjor i Selise se shenjte te Kryegjyshates Boterore Bektashiane.

Depozitimin e vendimit prane Gjkates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kerkuesi kerkon depozitimin e dokumentave perkatese, mbi keto ndryshime, prane Gjkates, konform ligjit.

Kerkesa dhe aktet e paraqitura, jane ne perputhje me ligjin dhe si e tille duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 39 e vijues te K.Civil dhe ne mbeshtetje te ligjit Nr. 8788 dhe Nr.8789, date 05.07.2001,e ligji nr.8781 date 03.05.2001

VENDOSA

Pranimin e kerkeses, dhe depozitimin e vendimit date 23.7.2011 te paraqitura nga 'Kryegjyshata Boterore Bektashiane'.

Urdherimin e Zyres se Regjistrit Tregtar, te beje ndryshimet perkatese.
Kunder ketij Vendimi, lejohet ankim:

GJYQTARE
REZARTA BALLIU(VIGANI)

Balliu

TE DHËNAT E LLOGARISË
ACCOUNT DETAILS

Banka / The Bank

CREDINS BANK sh.a., RRUGA 'VASO PASHA', Nr. 8, TIRANË

Kodi SWIFT / SWIFT Code

CDISALTRXXX

Titullari i Llogarisë / Account Holder

FONDACIONI FIRDEUS

Nr.Personal | NIPT / SSN | Tax ID

L716274530

Adresa e Klientit / Customer Address

RR ZONJA CURRE P ERMIR-STAR K1, TIRANE

Numri i Llogarisë / Account Number

00000883478

Monedha / Currency

ALL

Data e Çeljes / Account Start Date

16.01.2017

IBAN*

AL60 2121 1573 0000 0000 0088 3478

 CREDINS bank
Tirana, Shqipëria
07.05.2021
SHK 02